

FAKULTETI I DREJTESISË

STUDIME POSDIPLOMIKE

TEZË MAGJISTRATURE

Elementet e figurës së veprës penale në konkurrencën e lirë

KANDIDATI

Ornela Guranjaku

MENTORI

Prof.dr.Ismail Zejneli

PËRMBAJTJA

- HYRJE
- ARSYESHMËRIA E PUNIMIT
- METODOLOGJIA E PUNIMIT

KAPITULLI I

- 1.-Kuptimi dhe çështjet teorike mbi konkurencën e lirë
- 1.1 -Konkurrenca si një faktor i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në BE
- 2.- Aspekti historik mbi konkurrencën.
- 3.-Historiku i Marrëdhënieve BE-Shqipëri
- 4.-Vështrim krahasues mbi konkurrencen e lire
5. - Politika e Konkurrencës
- 6.-Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit: një Marrëveshje asimetrike
- 7.-Konkurrenca si një faktor i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në BE

KAPITULLI II

- 1.-Kuptimi dhe çështjet teorike mbi elementët e figurës së veprës penale ne konkurrencën e lirë
- 2.-Konkurrenca e pandershme sipas legjislacionit penal te Republikës së Shqipërisë
- 2.1.-*Monopolet shtetërore*
- 2.2.-Ndërhyrja e Autoritetit të Konkurrencës me qëllim mbrojtjen ekonkurrencës së lirë dhe efektive në treg
3. -Abuzimi me pozitën dominuese
4. -Procedimi penal.
- 5.-Mbrojtja e te drejtës së autorit ne rast cënimi
- 6.-Kuptimi i mashtrimeve kundër pasurisë

KAPITULLI I III

1. Parimet bazë të funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe zhvillimet kryesore (misioni ,vizioni dhe objektivat),
- 2.-Marrëdhënia e politikës së konkurrencës me politikat e tjera,
 - 2.1-Bashkëpunimi me institucionet homologe të konkurrencës
- 3.Konkurrenca si një faktor i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në BE, kultura e konkurrencës bashkëpunimi me Bashkimin Europian dhe (TAIEX) .
4. Kuadri ligjor dhe Politika Kombëtare e Konkurrencës

KAPITULLI IV

1. Të dhëna mbi vendimet e Komisionit të konkurrencës
 - 2.- Hetimi në Prokurimet publike
 - 3-. Hetimi në sektorin e prodhimit të betonit
 - 4.-Hetimin e thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit,
 5. -Rast për kontrollin e përqendrimeve / Hetimi në Sektorin Bankar
 - 6.-.Hetimi në tregun e telefonisë së lehtë

Përfundime dhe rekomandime

Literatura e shfytëzuar

SHKURTIME

AMF:	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare
AMC:	Albania Mobile Communication sh.a
AK:	Autoriteti i Konkurrencës
BE:	Bashkimi Evropian
CARDS:	Asistenca Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilitet
ERT:	Enti Rregullator i Telekomunikacionit
GTZ:	Asistenca Teknike Gjermane
HII:	Indeksi i Herfindahl-Hirschmann (Matës specifik i Përqëndrimit të Tregut)
ICN:	Rrjeti Kombëtar i Konkurrencës (International Competition Network)
IPA:	Instrumenti i Para Aderimit
KK:	Komisioni i Konkurrencës
KE:	Komisioni Evropian
LK:	Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”
MSA:	Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit
OECD:	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik
OBT:	Organizata Botërore e Tregtisë
OFNT:	Operatorë me Fuqi të Ndjeshme në Treg
PBB:	Produkti i Brendshëm Bruto
SSNIP:	Rritje e vogël dhe e vazhdueshme e çmimit
TKE:	Traktati i Komunitetit Evropian
TKQÇ:	Traktati i Komunitetit për Qymyrin dhe Çeliku

ARSYESHMERIA E PUNIMIT

Ndryshimet politike të viteve '90 u shoqëruan me domosdoshmërinë për të krijuar dhe zhvilluar ekonominë e lirë të tregut, pas mosfunksionimit të ekonomisë së centralizuar. Ashtu si në të gjitha vendet ish-komuniste, aspirata e shqiptarëve në ato vite ishte “Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa”. Kjo kërkonte zbatimin e një ekonomie të lirë tregu, ku konkurrenca në treg duhet të ishte një element thelbësor. Sfida për tu integruar në Bashkimin Europian e shtonte nevojën e ekzistencës së këtij faktori.

Lexuesi mund të pyesë se pse nevojitet konkurrenca dhe pse ajo konsiderohet si një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Konkurrenca shihet si promotori i ekzistencës së një ekonomie tregu. Dështimet e mundshme të tregut, kërkojnë ndërhyrjen e autoriteteve rregullatorë nëpërmjet mekanizmave ligjorë dhe institucional. Këto dështime ndeshen më së shumti në ekonomitë në tranzicion sikurse është ekonomia Shqiptare. Duke filluar nga vitet 90 e deri në ditët e sotme janë bërë ndryshime të ndjeshme për plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional duke synuar përafrimin e tij me legjislacionin dhe strukturat e vendeve evropiane. Konkurrenca mori një trajtim të gjithanshëm në jetën politiko-sociale, pasi sistemi paraardhës përgjithësisht e kishte përjashtuar konkurrueshmërinë dhe konkurrencën nga sferat e jetës dhe roli kryesor i takonte shtetit duke eliminuar tërësisht konkurrencën në drejtim të çmimeve në treg, kërkesës dhe ofertës. Gjithsesi përmirësime të mëtejshme janë të nevojshme.

METODOLOGJIA

Për hartimin e këtij punimi jam mbështetur në studimin e dokumentacionit dhe punimeve të mëparshme në këtë fushë, në intervistat e hapura si dhe në përdorimin e pyetësorëve. Përdorimi i këtyre tre elementëve i jep këtij punimi karakter teorik dhe praktik gjithashtu. Qëllimi kryesor ka qenë trajtimi teorik i koncepteve themelore e më pas analizimi praktik i tyre.

Studimi i dokumentacionit nënkupton përdorimin sistematik të materialeve të shtypura ose të shkruara për hulumtim. Studimi i dokumentacionit është në fakt një ndër metodat më të përdorura për mbledhjen e të dhënave sociologjike. Disa nga dokumentet më të konsultuar në studimet sociologjike janë të dhënat publike apo private si dhe studimet e mëparshme në të njëjtën fushë. Kjo metodë me ka shërbyer kryesisht për trajtimin e koncepteve teorike.

Gjatë këtij punimi është konsideruar si shumë e rëndësishme perceptimi i institucioneve, të cilat hartojnë dhe zbatojnë politikat në fushën e konkurrencës dhe integritetit evropian. Për këtë arsye janë zhvilluar intervista me drejtuesit kryesorë të këtyre institucioneve. Intervista janë kryer me Kryetaren e Autoritetit të Konkurrencës. Disa studime me intervista nuk shfrytëzojnë asnjë pyetësor dhe në rastet kur objektivi i studimit është të zhvillohet një informacion i thelluar mund të përfshihen vetëm disa të intervistuar. Intervistat e zgjatura sigurojnë material më të pasur nga çfarë përfitohet zakonisht me anketime.

Një rëndësi i veçantë, në këtë punim i është kushtuar trajtimit praktik të koncepteve, duke u fokusuar në mënyrën e perceptimit të tyre nga publiku dhe operatorët në treg (në rastin e konkurrencës), marrëdhënien ndërmjet tyre si dhe aplikimin e tyre praktikë. Për këtë arsye është përdorur një pyetësor, i cili i është drejtuar operatorëve, të cilët veprojnë në treg. Qëllimi i tij është analizimi i perceptimeve të operatorëve mbi konkurrencën, politikat në zbatim të saj, punën e institucioneve përgjegjëse si dhe nevojave për përmirësim.

HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është trajtimi teorik dhe marrëdhënia praktike i dy koncepteve kryesore: Konkurrenca e pandershme nga njëra, anë, dhe integrimi evropian nga ana tjetër. Konkurrenca është një fenomen kompleks që i referohet një situatë të një ekonomie të lirë të tregut në të cilën firmat në mënyrë të pavarur përpiqen të fitojnë sa më shumë blerës për të arritur objektivat e tyre. Ndërsa procesi i integritit evropian, është aktualisht procesi më i rëndësishëm, me të cilin po përballet qeveria shqiptare që pas viteve '90.

Marrëdhënia ndërmjet këtyre koncepteve mund të konsiderohet si një marrëdhënie varësie, ku secili prej tyre ndikon drejtpërdrejt në ekzistencën e tjetrit. Konkurrenca është promotori i tregut të lirë, ndërsa procesi i integritit nuk mund të konceptohet pa ekzistencën e këtij tregu. Konkurrenca brenda një shteti, është veçanërisht tepër e rëndësishme për konkurrueshmërinë, madje edhe në nivel global. Me qëllim anëtarësimin në Bashkimin Evropian, vendet duhet të kenë një ekonomi tregu funksionale të tillë që të mund t'i bëjë ballë presionit të konkurrencës dhe forcave të tregut të përbashkët të Bashkimit Evropian. Punimi do të jetë i strukturuar në katër kapituj kryesorë në të cilët do të kryhet analiza e punimit , gjithashtu një kapitull në gjuhën angleze si dhe kapituj të tjere plotësues, e në secilin prej tyre do të trajtohen në detaje dhe të mbështetur në teori dhe fakte, konkurrenca dhe integrimi evropian.

KAPITULLI I

1. Kuptimi dhe çështjet teorike mbi konkurrencën e lirë

Fjala konkurrencë etimologjine e ka nga fjala latineconcurrentio, qe dtth, kundërshtar garues.¹ Konkurrenca ne treg zhvillohet ne baze te rregullave te caktuara, prandaj secili subjekt pjesëmarrës në treg duhet tu permbahet këtyre rregullave qëllimi I të cilave është sigurimi i konkurrencës së lirë si rezultat i së cilës;

- Sigurohet iniciativa e subjekteve te ndryshme juridiko-ekonomike në treg,
- Sigurohet kunder vlera normale e faktorëve në prodhim,
- Krijohet një baraspeshë ndërmjet prodhimit dhe konsumit
- Ndikohet në prodhimtarinë nacionale dhe persoshmërine permanente në bazë të aplikimit dhe të përmirsimit tekniko-teknologjik në prodhimtari në pergjithësi.

Kornizën juridike për mbrojtjen e konkurrencës e përbëjnë ligji per mbrojtjen e konkurrences dhe aktet nënligjore për zbatimin e ketij ligji. Përcaktimi për garantimin e lirisë së tregut dhe mbrojtjen e pozitës së barabartë juridike të subjekteve në treg konsiderohen si vlera që jane të përcaktuara edhe me Kushtetutë.²

Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës parashikon se; kryerja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, e veprimeve të konkurrencës me anë të kërcënimit ose dhunës dënohet me burgim nga një deri në katër vjet. (neni 170/b).

Kur veprimet e konkurrencës drejtohen ndaj veprimtarive të financuara plotësisht ose pjesërisht dhe në çfarëdo mënyre nga shteti ose entet publike, dënimi me burgim shtohet me një të tretën.

Mosrregullimi i konkurrencës mund të shkaktojë ekzistimin e prodhimtarisë qe nuk është në përputhje me disa kërkesa të tregut e që mund të shkatojnë hiperprodukcion të të mirave materiale ose prodhimeve te pamjaftueshme qe kane si pasoje asgjesimin e panevojshem te te mirave material, duplikimin e kapaciteteve prodhuese, shpenzimeve joracionale etj.³

¹ Adnan Jashari, E drejta afariste, fq,507, Tetove, 2016

² Po aty

³ Po aty

Çfarë duhet të bëjmë n.q.s dyshojmë se një praktikë biznesi kufizon konkurrencën?

Në jetën tonë të përditshme, ne mund të ndodhemi para situatave të cilat paraqesin shenja të praktikave të biznesit të cilat mund të kufizojnë konkurrencën. Në një rast të tillë, menjëherë zgjidhja do të ishte informimi pa vonesë i Autoritetit të Konkurrencës për praktikën potenciale antikonkurrese të dyshuar. Paraqitja e një ankese të tillë do të ndihmonte AK në evidentimin e rastit antiligjor dhe në fillimin e mundshëm të praktikave investiguese .

Megjithatë, duke qenë se në të gjithë jemi konsumatorë individualë, informimi i një prej shoqatave të mbrojtjes së konsumatorit do të ishte një zgjidhje e mundshme. Në këtë rast është shoqata e mbrojtjes së konsumatorëve e cila formon një ankesë dhe i drejtohet AK.

Si mund të marr më tepër informacion ?

- Nga interneti. Informacion i detajuar gjendet në faqen zyrtare të AK-së. Aty gjendet baza ligjore, vendimet, publikimet, deklaratat për shtyp, intervistat, hetimet e filluara etj (www.caa.gov.al).
- Informacion i printuar. Publikime të ndryshme të AK-së të tilla si Buletini i Vendimeve, Politika Kombëtare e Konkurrencës, Raportet Vjetore 2008, 2009, 2010 Fjalori i Termave të Konkurrencës, etj.
- Duke ju drejtuar AK me shkresë ose e-mail. Në këtë rast anëtarë të stafit të AK-së do t'u sigurojnë informacionin të cilin ju e dëshironi dhe që nuk përbën informacion konfidencial apo sekrete biznesi

1.1 Konkurrenca si një faktor i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në BE

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit, Shqipëria ka hyrë në një fazë të re të partneritetit me Bashkimin Evropian. Kjo fazë kërkon zbatimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, detyrime të cilat nuk janë gjë tjetër veçse zbërthimi i tre kritereve të Kopenhagenit: kriterin politik, ekonomik dhe atë të legjislacionit. Kriteri ekonomik kërkon që Shqipëria të zhvillojë një ekonomi tregu, të aftë për ti ballë konkurrencës së tregut të brendshëm të Bashkimit Evropian. Në funksion të krijimit të një ekonomie të tillë, konkurrenca mund të konsiderohet si elementi themelor.

Çështjet e konkurrencës mbeten tejet të rëndësishme për tregun e përbashkët evropian dhe vendet anëtare. Realizimi i tregut të brendshëm bazohet tek konkurrenca midis prodhuesve të mallrave dhe shërbimeve. Politika e konkurrencës është konsideruar gjithmonë e domosdoshme në nivelin komunitar me qëllim që të favorizojë efektshmërinë ekonomike dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, të cilët mund të përfitojnë në këtë mënyrë të mira dhe shërbime në kushte më të mira. Kjo politikë është përcaktuar që në fillim në Traktatin e Romës dhe mund të konsiderohet si një nga politikat më të rëndësishme të Komunitetit. Politika evropiane e konkurrencës zhvillohet në pesë drejtime:

- Ajo ka për objektiv të *eliminohet monopolizimin e disa tregjeve* duke ndaluar që ndërmarrjet, me anë të marrëveshjeve proteksioniste, të ndajnë tregun mes tyre. Neni 81 i Traktatit i ndalon marrëveshjet dhe praktikatat e rregulluara bashkërisht midis ndërmarrjeve, të cilat mund të prekin tregtinë midis shteteve anëtare dhe që kanë si objektiv ose që sjellin pengimin, kufizimin apo prishjen e lojës së konkurrencës brenda tregut të përbashkët. Në marrëveshjet e ndaluara bëjnë pjesë gjithashtu marrëveshjet që caktojnë direkt ose indirekt çmimet, marrëveshjet mbi kushtet e shitjes, përcaktimin e kuotave të prodhimit, marrëveshjet që ndajnë tregjet apo burimet e financimit etj. Gjithsesi disa tipe bashkëpunimesh të konsideruar pozitive, mund të autorizohen nga Komisioni në momentin që ato lejojnë përmirësimin e prodhimit dhe të shpërndarjes, ose kur ato promovojnë progresin teknik ose ekonomik (për shembull marrëveshjet e ekskluzivitetit, marrëveshjet që lejojnë transferimin e teknologjisë, marrëveshjet e specializimit apo ato të zhvillimit dhe marrëveshjet kërkimore). Komisioni ka të drejta të shumta për të hetuar mbi ndërmarrjet e dyshimta për praktika monopoliste. Në fund të një procedure që i jep ndërmarrjes mundësinë për tu mbrojtur Komisioni mund të kërkojë që ti jepet fund praktikës në fjalë. Ai gjithashtu mund të imponojë gjopa në shumën 10% të xhiros vjetore. Ndërmarrja mund të bëjë një ankim pranë Gjykatës së Drejtësisë, por përgjithësisht Komisioni dhe Gjykata ndjekin të njëjtat orientime.
- Politika evropiane e konkurrencës synon të *mënjanojë abuzimin e pozicionit dominues*. Një pozicion dominues është një situatë supremacie ekonomike që i lejon një ose shumë ndërmarrjeve të pengojnë mbajtjen e një konkurrence të vërtetë në treg dhe ka abuzim të pozicionit dominues kur qëndrimi i kësaj ndërmarrjeje mund të influencojë mbi

strukturën ose shkallën e konkurrencës në treg. Në rastet e abuzimit të pozicionit dominues Komisioni ndërhyt.

- Për të *mënjënuar krijimin e pozicioneve dominuese*, përqendrimit e ndërmarrjeve kontrollohen kur bëhet fjalë për ndërmarrje mbi një masë të caktuar dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre në shumë shtete anëtare. Këto përqendrime duhet të deklarohen në Komision, i cili mund ti ndalojë kur ato krijojnë ose përforcojnë një pozicion dominues nga i cili rrjedhin pengesa të rëndësishme për një konkurrencë të vërtetë. Ndalime të tilla bëhen rrallë, por ato përbëjnë një kërcënim të dobishëm. Bashkimet e ndërmarrjeve janë shumëfishuar që prej viteve '80 dhe sidomos '90, janë bërë shpesh të nevojshme për të përballuar konkurrencën ndërkombëtare.
- Politika e konkurrencës ka gjithashtu si objektiv të *ndalojë ndihmat publike që tjetërsojnë konkurrencën* duke favorizuar disa ndërmarrje apo disa prodhime. Megjithatë Traktati parashikon përjashtime të ndryshme, veçanërisht për ndihmat e caktuara për promovimin e zhvillimit ekonomik të disa aktiviteteve apo disa rajoneve. Për çdo ndihmë apo regjim ndihmesh duhet të njoftohet Komisioni dhe ai duhet ta aprovojë atë para se ajo të jetë hedhur për ekzekutim. Edhe sot Komisioni dhe Këshilli kanë si detyrë të zvogëlojnë nivelin e përgjithshëm të ndihmave publike dhe të mos lejojnë që këto ndihma të tjetërsojnë konkurrencën, duke privilegjuar objektivat horizontale si përkrahja ekonomike dhe sociale.

Rregullat e konkurrencës zhvillohen si në ndërmarrjet publike ashtu edhe në ato të cilave shtetet anëtare u japin të drejta të veçanta dhe ekskluzive. Sipas Nenit 86 të Traktatit ndërmarrjet e ngarkuara për administrimin e një shërbimi me interes ekonomik të përgjithshëm apo që paraqesin karakterin e një karakterin e një monopoli fiskal, u nënshtrohen rregullave të konkurrencës deri në masën që zbatimi i këtyre rregullave nuk lejon përmbushjen, sipas të drejtës apo praktikës, të misionit të veçantë që u është ngarkuar bashkërisht.

Komisioni dhe gjykatat evropiane e zbatojnë ligjin dhe politikën e konkurrencës gjithmonë duke pasur parasysh funksionimin e një tregu të vetëm. Procesi i anëtarësimit të dymbëdhjetë shteteve të reja si dhe negociatat me shtetet e tjera kandidate dhe kandidate potenciale, kanë treguar se edhe për politikën e konkurrencës, çështja thelbësore është Integrimi Evropian.

Për të lehtësuar procesin e integritit evropian, Bashkimi Evropian e konsideron të nevojshme dhe të domosdoshme që, duke filluar nga dita e parë e hyrjes në bashkësinë evropiane, të gjitha shtetet candidate të njohin e të zbatojnë kuadrin ligjor në fuqi. Ekonomitë e shteteve anëtare duhet të fillojnë të funksionojnë brenda një kuadri të pranueshëm rregullator, që ndalon zhvillimin e tregjeve kundër interesave të vetë vendeve të asociuara dhe krijimin e strukturave të monopolizuara dhe jo-eficente. Në këtë mënyrë, një politikë aktive konkurrence do të ndihmonte në procesin e tranzicionit, duke krijuar struktura të shëndetshme ekonomike dhe duke shmangur përfitimet antiligjore dhe jo normale.

Është e rëndësishme që procesi i përafrimit, i përcaktuar në marrëveshjet evropiane, të vazhdohet në të gjitha fushat e politikës së konkurrencës. Marrëveshjet nuk kërkojnë detyrimisht përshtatjen e plotë të “*acquis communautaire*” në fushat respektive dhe me të gjitha hollësitë, por është e detyrueshme që të harmonizohen parimet bazë, brenda një kuadri të përshtatshëm strukturor. Duhet të theksojmë se procesi i integritit nuk është i kufizuar vetëm në përshtatjen e ligjeve dhe të rregulloreve ose në ndërtimin e strukturës.

Përprjekje të vazhdueshme duhet të bëhen për të siguruar zbatimin e politikës, për ta bërë atë të njohur publikisht dhe për ta pranuar nga të gjithë aktorët ekonomikë të përfshirë në proces pra, për qeveritë, ndërmarrjet dhe shoqatat e tyre si dhe sigurisht për konsumatorin. Tregu më i gjerë pranohet nga të gjithë lojtarët, vetëm nëse përcaktohen rregulla loje të barabarta dhe kërkohet zbatimi efektiv i tyre. Dështimi në këtë aspekt, do të sillte konflikte të cilat sigurisht që do të çonin në rishfaqjen dhe rivendosjen e kufijve dhe masave mbrojtëse të shteteve anëtare karshi njëra tjetrës.

Detyrimi i palës shqiptare është njohja dhe përafrimi i standardeve evropiane në politikën e brendshme të konkurrencës. Këto detyrime janë parashikuar në Nenet 70 dhe 71 të MSA, rekomandimet që rrjedhin nga Raport Progresi Vjetori i KE dhe prioritetet e Dokumentit të Partneritetit Evropian. Detyrimet themelore në këtë fushë janë përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit, forcimi i autonomisë së Autoritetit të Konkurrencës si dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe teknike në këtë fushë me qëllim zbatimin e rregullave të lojës së ekonomisë së tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Në Raport Progresin Vjetor të KE të vitit 2007 janë mirëpritur zhvillimet e fundit në këtë fushë. “Janë shënuar disa përparime në fushën e antitrust. Është miratuar një politikë për konkurrencën e cila do të shërbejë si një guidë për ngritjen e tregut të lirë dhe efikas të

konkurrencës, ku prioritetet janë telekomunikacionet, energjia dhe shërbimet financiare. Është rritur numri i stafit në 35 punonjës. Është miratuar struktura e re. Është kontribuar në drejtim të promovimit të kulturës së konkurrencës.” Ndërsa prioritetet e Dokumentit të Partneritetit Evropian për konkurrencën janë:

- Të përmirësohet dhe të përafrohet me *acquis* legjislativ ekzistues (antitrust) për forcimin e kontrollit mbi konkurrencën,
- Të forcohen kapacitetet administrative të Autoritetit të Konkurrencës dhe të pajiset me trajnimin dhe personelin e duhur.

Për t’ju përgjigjur realizimit të këtyre angazhimeve, Autoriteti i Konkurrencës, ka ndërmarrë disa veprime shumë të rëndësishme. Ato kanë synuar të drejtohen kah fokusit kryesor të rekomandimeve të BE: përafrimit të legjislativ, fuqizimit të autonomisë së tij si dhe forcimit të kapaciteteve administrative. Mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive, si detyrë të vazhdueshme dhe parësore të përcaktuar nga Ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës e ka parë gjithmonë të lidhur ngushtë me përafrimin e akteve ligjore dhe nënligjore të legjislativ vendas, me aktet juridike të BE-së.

Rregulloret e përcaktuara në nenin 84 të ligjit të mësipërm e në zbatim të tij, për plotësimin e të drejtës vendase të konkurrencës, janë hartuar në përputhshmëri të plotë me aktet juridike përkatëse të BE-së. Njëkohësisht çdo akt juridik vendas, që hartohet për nevojat e kësaj të drejte, referohet gjithmonë me analogen e saj të BE-së. Përveç përafrimit të legjislativ shumë i rëndësishëm është zbatimi i tij. Kjo kërkon ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve të tregut, për të marrë vendimet e tyre në përputhje me kuadrin ligjor të përcaktuar. Vetëm në këtë mënyrë tregu jep mundësinë e plotë të përfitimeve. Si hap i parë në këtë drejtim është paraparë përcaktimi i procedurës që do të ndiqej për përafrimin e legjislativ aktual dhe për këtë është hartuar Metodologjia e Përafrimit të Legjislativ.

Kjo është parë si një detyrë e rëndësishme e Autoritetit të Konkurrencës, për të përmbushur pjesën e tij të detyrimeve që i takojnë në kuadrin e Paktit të Stabilitetit dhe Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që ka nënshkruar vendi ynë me vendet anëtare të BE-së. Këto detyra janë të përcaktuara qartë në nenet 6,40,70,71,72 të MSA-se ose dhe në nenet 27, 38, 39 të Marrëveshjes së Ndërmjetme (Interim). Në bazë të këtyre detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e mësipërme përfshi këtu edhe partneritetin evropian, Autoriteti i Konkurrencës

është angazhuar që për një periudhe 2-3 vjeçare të japë rekomandimet e duhura mbi rregullimin e monopoleve shtetërore dhe të marre masa për të shmangur diskriminimin e konkurrenteve të huaj me firmat monopoliste shtetërore. Si prioritet afatgjatë parashikohet ecja drejt vendosjes së një disipline të plotë në zbatimin e rregullave të konkurrencës në Shqipëri, për të siguruar një mjedis sa me konkurrues dhe për të rritur kulturën e konkurrencës.

Objektivi kryesor i ligjit të konkurrencës dhe i politikës së konkurrencës është eficienta ekonomike evropiane si dhe integrimi evropian i tregut. Politika e konkurrencës është një mënyrë për të arritur shpërndarjen optimale të burimeve, të promovohet progresi teknologjik, dhe të adoptohen drejt një mjedisi të ndryshueshëm. Puna për përafrimin e legjislacionit fokusohet kryesisht në hartimin e atyre akteve nënligjore, të cilat lidhen me futjen e koncepteve dhe procedurave evropiane që kanë të bëjnë me:

- llojet e marrëveshjeve të ndaluara,
- mënyrën e identifikimit të abuzimeve me pozitën dominuese si dhe
- llojet e procedurave për kontrollin e përqendrimeve. Këto aspekte lidhen edhe me funksionin tjetër të rëndësishëm të AK, atë të vendimmarrjes së KK, të referuar në nenin 24, germa f, të ligjit në të cilin del në pah roli rekomandues i tij. Detyrat vendimmarrëse përfshijnë jo vetëm punën përgatitore që lidhet me daljen dhe ekzekutimin e vendimeve, por edhe rëndësinë e identifikimit të AK përmes rekomandimeve që jep në mbrojtje të konkurrencës së lirë dhe efektive.

2. Aspekti historik mbi konkurrencën.

Origjina e politikës moderne të konkurrencës gjendet në fund të shekullit të XIX, kryesisht si një reagim ndaj formimit të trusteve në SHBA. Kjo periudhë u karakterizua nga një zhvillim i madh i infrastrukturës (hekurudhat) dhe telekomunikacionit (linjat telegrafike dhe shërbimet telefonike). Në gjysmën e dytë të këtij shekulli, eksperiencia e SHBA-ve numëronte një numër rastesh të cilat rezultojnë në transformimin e industrive prodhuese. Ngjarja më e rëndësishme lidhet me përmirësimet në transport dhe komunikim. Hekurudhat u zgjeruan në mënyrë shumë të shpejtë dhe njëkohësisht edhe linjat telegrafike dhe shërbimet telefonike, duke i dhënë mundësinë një numri të vogël firmash të zhvillonin ekonominë e shkallës dhe ekonominë e qëllimit.

Gjysma e dytë e shekullit të XIX u karakterizua nga një paqëndrueshmëri çmimesh dhe rënie ekonomike, për arsye të faktorëve makroekonomik të cilat krijuan destabilitet në sektorin e shërbimeve. Firmat shpesh përpiqeshin që t'i kundërpërgjigjeshin luftës së çmimeve dhe destabilitetit të tregut nëpërmjet marrëveshjeve të çmimeve të cilat i mundësonin ata të mbanin çmime të larta. Organizimi i karteleve dhe trusteve kanë pikërisht këtë qëllim. Si rezultat, konsumatori final dëmtohej dhe njëkohësisht edhe prodhuesit, të tillë si fermerët dhe firmat që bënin pjesë në industrinë e vogla, të cilët përdornin produktet e sektorëve kartel si input të tyre. Reagimet e fermerëve dhe bizneseve të vogla (të cilët kishin influencë të mjaftueshme) çuan në krijimin e ligjeve antitrust.⁴

Në vitin 1890,⁵ u adoptua ligji federal, *Sherman Act*, sipas të cilit: “Çdo kontratë, kombinim i formës së trusteve ose më gjerë, konspiracion, kufizim në tregti ose treg ndërmjet disa shteteve ose me shtete të huaja, deklarohet i papajtueshëm më ligjin”. Kështu, firmat që donin të koordinonin çmimet kishin si opsjon të bashkoheshin në një firmë të vetme duke mos u prekur kështu nga *Sherman Act*. Për këtë arsye më vonë u vendos *Clayton Act* i cili mbulonte atë pjesë të bashkimit të firmave të cilat do të kufizonin konkurrencën në treg. *Sherman Act* përbëhej nga dy pjesë.

Pjesa e parë e këtij akti ndalon kontratat dhe kombinimet të cilat kufizojnë tregtinë dhe përshkruan masa për ata të cilët e shkelin ligjin. Pjesa e dytë ndalon monopolet, përpjekjet për të krijuar monopol brenda Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe pjesës tjetër të botës. Në ditët e sotme ligji antitrust ka ndryshuar shumë nga ai i shekullit të XIX. Ato bashkime që atëherë konsideroheshin si të ligjshme dhe i përshtateshin kushteve të tregut, duke filluar nga vitet ‘40 konsiderohen si të paligjshme. Ndryshimet përforcuan idenë se tregu duhet të lihej i lirë dhe se duhej të ishte ai vetë i cili të zgjidhte firmat më të mira dhe të afta të cilat do të ishin në gjendje të konkurronin.

Në Bashkimin Evropian ligji për konkurrencën gjendet në nenet e TKE-së. Politika e konkurrencës në BE rregullohet nga dy juridiksione dhe pikërisht nga ai në nivel kombëtar, që ka çdo shtet anëtar, dhe nivel komunitar, që ka KE. Karakteristikë e shteteve anëtare është se një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk kanë një ligj specifik për konkurrencën, por vetëm një zgjerim dhe interpretim të dispozitave të TKE-së dhe më pas kanë bërë modifikime të ndryshme duke

⁴ Antitrust Law Developments (fourth), *Section of Antitrust Law American Bar Association*

⁵ Traktati i Komunitetit Europian

pasqyruar kuadrin ligjor të BE-së. Politika e Konkurrencës konsiderohet si politika më e rëndësishme për rregullimin e tregut në BE. Nismën e parë për krijimin e dispozitave të para për praktikant anti konkurruese në Evropë i gjejmë në Traktatin e Parisit në vitin 1951 ku vende si Franca, Italia paraqitën shqetësimin dhe ndërmorën masa për praktikant anti konkurruese duke krijuar Komunitetin Evropian të Qymyrit dhe Çelikut.⁶

Nëpërmjet këtij Traktati ndaloheshin barrierat tregtare dhe diskriminuese ose çdo praktikë e cila potencialisht mund të prishte konkurrencën midis vendeve anëtare të Traktatit. Në këtë mënyrë neni 81 i TKE-së është përmirësim i nenit 65 të Traktatit të Parisit duke ndaluar kështu marrëveshjet midis firmave të cilat tentojnë të pengojnë, kufizojnë apo shtrembërojnë konkurrencën në Tregun e Përbashkët. Neni 82 i TKE-së është pasqyrim i nenit 66 të atij të Parisit duke ndaluar abuzimin me pozitën dominuese.

3. Historiku i Marrëdhënieve BE-Shqipëri

Marrëdhëniet diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian janë vendosur në vitin 1991 duke kulmuar me nënshkrimin në 11 maj 1992, të Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit Ekonomik si dhe deklaratën e përbashkët mbi dialogun politik, e cila hyri në fuqi më 1 dhjetor 1992. Kjo Marrëveshje ishte në thelb të saj një kontratë, në të cilën BE angazhohej që të mbështeste Shqipërinë nëpërmjet instrumenteve institucionale dhe financiare për kalimin në një ekonomi të decentralizuar. Ajo i krijoi mundësinë Shqipërisë që të përfitojë nga fondet e programit PHARE, të cilët patën një ndikim shumë të madh në përmirësimin e cilësisë së jetës në Shqipëri. Një zhvillim tjetër i rëndësishëm, më karakter ekonomik, ishte përfshirja e Shqipërisë në Sistemin e Përgjithshëm të Preferencave (GSP), i cili përfaqësonte një regjim të përgjithshëm preferencash tregtare që Bashkimi Evropian u ofronte një numri të gjerë vendesh me të cilat kishte marrëdhënie kontraktore.⁷

Marrëveshja monitorohej në mënyrë të kujdesshme nga Institucionet e Bashkimit Evropian dhe strukturat e përbashkëta BE-Shqipëri të krijuara për këtë qëllim. Zbatimi i saj pati një impakt te

⁶ TKQÇ: Traktati i Komunitetit për Qymyrin dhe Çeliku

⁷ *Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 215, datë 16.5.2002, "Për ngritjen dhe funksionimin e grupit negociator shqiptar për përgatitjen e negociatave me Komunitetin Evropian dhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit"*

madh goditës dhe promovues, sepse solli efekte pozitive dhe negative për prodhuesit shqiptarë, për të cilët ekonomia e tregut ishte thuajse e panjohur në atë periudhë. Por gjithsesi ajo pati një ndikim shumë të rëndësishëm në hapat e mëtejshëm për krijimin dhe forcimin e ekonomisë së tregut.

Në mbledhjen e tij të mbajtur në Kopenhagen më 1 Qershor 1993, Këshilli caktoi tri kriteret bazë që vendet candidate duhet të plotësojnë para se të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian.

- Kriteri Politik, sipas të cilit vendet që aspirojnë të anëtarësohen në BE duhet të kenë institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve;
- Kriteri Ekonomik, i cili përcakton se vendet duhet të kenë një ekonomi tregu funksionale të tillë që të mund ti bëjë ballë presionit të konkurrencës dhe forcave të tregut të përbashkët të Bashkimit Evropian;
- Kriteri i adoptimit të “*acquis communautaire*” dhe forcimit të kapaciteteve institucionale me qëllim përmbushjen e detyrimeve që vijnë nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian.

Duke u nisur nga ritmi i zhvillimeve ekonomike dhe politike në vitin 1996, Shqipëria ishte pranë nënshkrimit të një marrëveshjeje të re kontraktuale me BE-në, e cila do të hapte rrugën për një marrëveshje asociimi. Por, zgjedhjet e kontestuara parlamentare të majit të vitit 1996, së bashku me krizën e thellë financiare dhe sociale që pasoi në fillim të vitit 1997, bënë që të dështojë çdo iniciativë në këtë drejtim. Një impakt negativ patën gjithashtu zhvillimet politike në Ballkanin Perëndimor, si shpërbërja e ish-Jugosllavisë, krijimi i një sërë shtetesh të reja, etj..

Duke u nisur nga kjo situatë dhe duke marrë në konsideratë perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në vitin 1996 Këshilli i Çështjeve të Përgjithshëm adaptoi për këto vende politikën e quajtur “Qasja Rajonale” (Regional Approach). Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme, përcaktonte një sërë kushtesh politike dhe ekonomike që vendet e Ballkanit duhej të plotësonin për të zhvilluar dhe forcuar marrëdhëniet e tyre me BE-në. Këto kritere kishin të bënin me respektimin e parimeve demokratike, liritë dhe të drejtat e njeriut, ndërtimin, respektimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës, mbrojtjen e minoriteteve, zhvillimin e ekonomisë së tregut, si dhe bashkëpunimin rajonal.

Kjo Politikë pati ndikimin e saj, kryesisht në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet vendeve të rajonit, por dështoi në disa aspekte, sikurse ishte sigurimi i paqes në rajon. Për këtë arsye, e me qëllim forcimin e rolit në rajon, në vitin 1999, BE miratoi për vendet e Ballkanit Perëndimor, iniciativën e re të quajtur “Procesi i Stabilizim-Asociimit”, pjesë e të cilit ishin: Shqipëria, Maqedonia, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Kosova si dhe Serbi-Mal i Zi.⁸

Nëpërmjet këtij procesi, synohet forcimi i bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe vendeve të lartpërmendura, nëpërmjet Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit (MSA). Me qëllim mbështetjen e Shqipërisë në këtë proces, në vitin 1999, Komisioni Evropian paraqiti një raport mbi studimin e fizibilitetit për hapjen e bisedimeve me Shqipërinë për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit duke arritur në përfundimin se, megjithatë, Shqipëria nuk i kishte plotësuar kushtet për një marrëveshje të tillë, duhej të hapeshin bisedimet. Perspektiva e vendeve të rajonit perëndimor për integrim në Bashkimin Evropian përforcohet pas Këshillit Evropian të Feiras i mbledhur më qershor 2000, i cili vendosi se të gjitha vendet e përfshira në Procesin e Stabilizim-Asociimit janë kandidatë potenciale për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Shumë i rëndësishëm për perspektivën evropiane të Shqipërisë, konsiderohet Samiti i Zagrebit, i zhvilluar në vitin 2000, në të cilin BE vendosi të intensifikojë bashkëpunimin me Shqipërinë nëpërmjet krijimit të Grupit të Nivelit të Lartë Drejtues Shqipëri-BE. Qëllimi i këtij grupi ishte të vlerësonte kapacitetin e Shqipërisë për të marrë përsipër detyrimet për një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi me BE, i cili pas disa misioneve në Shqipëri, arriti në përfundimin se: ndonëse mbetet ende për të bërë ne drejtim të plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga një marrëveshje stabilizim-asociimi, perspektiva e hapjes së negociatave është rruga më e mirë për të ruajtur tempin e ndryshimeve politike dhe reformave ekonomike në vend.

Nisur nga ky përfundim, Komisioni i propozoi Këshillit hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Shqipërinë. Nga ana e tij në qershor 2001, Këshilli i Ministrave të BE-së miratoi raportin e Komisionit dhe i kërkoi atij që të paraqiste një projekt-mandat për hapjen e negociatave me Shqipërinë përpara fundit të vitit 2001. Në përputhje me kërkesën e Këshillit, në muajin dhjetor 2001, Komisioni Evropian i paraqiti Këshillit projekt-mandatin e vendet anëtare të BE-së gjatë periudhës Janar-Korrik 2002, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE në

⁸ *Trajnim mbi çështjet ligjorë të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore.* Projekti CARDS 2003

mbledhjen e tij më 21 tetor 2002, vendosi hapjen e negociatave me Shqipërinë. Negociatat për një Marrëveshje Stabilizim Asociimi BE-Shqipëri u hapën zyrtarisht nga Presidenti i Komisionit Evropian Z. Romano Prodi më 31 janar 2003. Marrëveshja e Stabilizim-Asoimit (MSA) mbështetet në Nenin 310 të Traktatit të Komunitetit Evropian (TKE), i cili parashikon: *“Komuniteti mund të nënshkruajë me një ose disa Shtete ose organizata ndërkombëtare, marrëveshje që krijojnë një asociim të karakterizuar nga të drejta dhe detyrime reciproke, veprime të përbashkëta dhe procedura të veçanta”*.⁹

Me qëllim negocimin e kësaj Marrëveshje, Qeveria Shqiptare ngriti një Grup Ndërinstitucional pune, të kryesuar nga Ministri i Integritit, ndërsa për palën evropiane, Marrëveshja do të negociohej nga përfaqësues të Komisionit Evropian, të kryesuar nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Marrëdhënieve me Jashtë. Negociatat për MSA kanë qenë të karakterit teknik dhe politik. Në raundet teknike, janë diskutuar nenet që lidhen kryesisht me pjesën ekonomike-tregtare dhe ajo e politikave sektoriale, ndërsa në raundet politike fokusi i diskutimit ishin nenet me karakter politik, kryesisht ato të drejtësisë dhe çështjeve të brendshme dhe ato të politikës së jashtme dhe sigurisë së përbashkët.

Pas zhvillimit të tetëmbëdhjetë raunde negociatash nga të cilët shtatë raunde politike dhe njëmbëdhjetë teknike negociatash, procesi i negocimit u mbyll më 8 shkurt 2006, duke konkluduar dhe me përafrimin e MSA-së. Ky proces kulmoi me datë 12 Qershor 2006, me nënshkrimin e MSA-së nga Kryeministri shqiptar, si përfaqësues i palës shqiptare, Komisionari Evropian për Zgjerimin si përfaqësues i institucioneve të BE dhe të gjithë Ministrat e Jashtëm të shteteve anëtare për palën evropiane.

Nënshkrimi i MSA nënkupton hyrjen në fuqi, pas 6 muajve, vetëm të neneve të saj të cilat përcaktojnë rregullimet ekonomike dhe tregtare, ndërsa MSA si e tërë do të hyjë në fuqi, pasi të ratifikohet nga Parlamentet e të gjithë Shteteve Anëtare. Që nga 1 Dhjetori 2006, Qeveria Shqiptare dhe Qeveritë e Shteteve Anëtare po zbatojnë dispozitat ekonomike dhe tregtare të MSA, ose siç njihet ndryshe: Marrëveshjen e Ndërmjetme.

Pra që pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asoimit, në pritje të përfundimit të ratifikimit të kësaj marrëveshje nga parlamentet e të gjitha shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, nenet e një pjese të kësaj Marrëveshje, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me lëvizjen e lirë të mallrave, dispozitat mbi Transportin si dhe përafrimin e legjislacionit në disa fusha

⁹ *Shqipëria dhe Bashkimi Evropian, MSA dhe më pas*, Ministria e Integritit, 2006

thelbësore të lidhura ngushtësisht me realizimin e tregut të përbashkët, zbatohen në bazë të Marrëveshjes së Ndërmjetme midis Komunitetit Evropian dhe Shqipërisë.

Nenet e tjera të MSA-së do të hyjnë në fuqi me ratifikimin e saj nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Një zgjidhje e tillë është bërë me qëllim që efektet tregtare të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit të fillojnë të konkretizohen sa më shpejt që është e mundur, pa u vonuar nga procedura komplekse e përfundimit formal të Marrëveshjes. Aktualisht, Shqipëria ka përshkruar dy prej shtatë fazave që duhen kaluar për tu anëtarësuar në BE. Fazat që ka kaluar Shqipëria janë: (i) fillimi i negociatave të MSA dhe (ii) nënshkrimi i MSA, mbeten për të kaluar: (i) hyrja në fuqi e MSA, (iii) dhënia e opinionit nga BE, (iii) fillimi i negociatave të anëtarësimit, (iv) nënshkrimi i traktatit të anëtarësimit dhe (v) përcaktimi i datës së anëtarësimit. Duke u nisur prej fazës së tanishme dhe rasteve të vendeve të tjera, që kanë kaluar procesin e integritit evropian, anëtarësimi i Shqipërisë në BE mund të ndodhë pas 4-21 vjetësh, në periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2027.

4. Vështrim krahasues mbi konkurrencën e lirë

Nëpërmjet kësaj analize synohet të vihet në dukje statusi i institucionit tonë krahasuar me vendet që kanë hyrë në BE dhe ato që janë kandidatë, kompetencat që ligji i ka dhënë institucionit përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës, mënyrat e raportimit të këtyre institucioneve, përafrimi i legjislacionit, rolin e gjykatës, medias, konsumatorit, bizneseve, etj..

Nga analiza e kryer me institucionet homologe të vendeve të rajonit, dhe vendeve të reja anëtare të Bashkimit Evropian, rezulton se kuadri ligjor dhe institucional i Shqipërisë vepron mbi të njëjtat standarde të vlerësimit të praktikave që pengojnë, shtrembërojnë apo kufizojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Edhe strukturat publike për mbrojtjen e konkurrencës, krahasuar me zhvillimin në vendet fqinje, janë në faza të ngjashme, drejt krijimit ose konsolidimit të tyre, dhe kjo përgjithësisht përputhet me fazën në të cilën ndodhet procesi i integritit evropian në vendin tonë.

Në varësi të procesit të integritit, institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës janë ngritur dhe krijuar në periudha të ndryshme kohore. Kështu, për Rumaninë dhe Bullgarinë të cilat janë tashmë Anëtare të BE, institucionet e AK janë ngritur në mesin e viteve '90 ndërsa Autoriteti Maqedonas i Konkurrencës ashtu si dhe ai Shqiptar është krijuar në vitin 2004.

Karakteristikë e përbashkët e këtyre vendeve është se legjislacioni mbi konkurrencën është i përafruar me standardet dhe kuadrin ligjor evropian. Tipar dallues në ligjin e konkurrencës në Maqedoni në krahasim me atë Shqiptar është përfshirja në ligj edhe e nocioneve të ndihmës shtetërore. Megjithatë, ka shumë tipare ngjashmërie si p.sh: mënyra e organizimit të institucionit, numrit të stafit (kanë numër afërsisht të njëjtë anëtarësh) mënyrën e zgjedhjes së Komisionit të Konkurrencës, etj..

Ashtu si edhe në ligjin shqiptar, edhe ligji rumun mbi konkurrencën nuk ndalon pozitën dominuese në treg, por abuzimin me pozitën dominuese. Këto ndërmarrje do t'i nënshtrohen ligjit vetëm nëse ato nëpërmjet mjeteve antikonkurruese, ndërhyjnë në treg duke penguar, kufizuar apo shtrembëruar konkurrencën në treg. Tipar dallues është roli i gjykatës, medias dhe konsumatorit, të cilët luajnë një rol më të ndjeshëm në Rumani sesa në vendin tonë, nëpërmjet sensibilizimit dhe informimit të publikut lidhur me çështjet e konkurrencës.

Ashtu si edhe ligji shqiptar edhe ligjet e të tre vendeve parashikojnë gjoba penalizuese pothuajse në të njëjtat masë për praktikant antikonkurruese. Gjithashtu ligjet parashikojnë programet e lehtësimit nga gjobat ashtu siç parashikon edhe ligji shqiptar, por ndërsa gjobat në Rumani dhe Bullgari vendoseshin në varësi të xhiros vjetore. Në Maqedoni kjo shumë është fikse.

Ligjet e të tre shteteve ashtu si dhe ligji shqiptar i konkurrencës parashikojnë disa lloj marrëveshesh të cilat janë të lejueshme dhe përjashtohen nga ndalimi i tyre. Në këtë rast bëhet fjalë për ato lloj marrëveshesh të cilat sjellin fitime pozitive për progresin e ekonomisë dhe si të tilla janë të lejueshme.

Tipar i përbashkët për të gjitha vendet është raportimi vjetor i detyrueshëm por ka ndryshim në organin të cilit i drejtohet ky raportim. Maqedonia raporton para qeverisë në krahasim me vendet e tjera së bashku me Shqipërinë të cilat raportojnë në Parlamentet e tyre Kombëtare. Raportet vjetore në të gjitha shtetet botohen në faqen zyrtare të Autoriteteve të Konkurrencës.

5. Politika e Konkurrencës

Politika e konkurrencës në Shqipëri përfaqëson tërësinë e masave dhe të kuadrit ligjor brenda të cilit ndërmarrjet që veprojnë në sektorin privat apo atë publik mund të ushtrojnë lirisht mbi baza të një konkurrencë të lirë efektive e të ndershme, aktivitetin e tyre ekonomik. Politika e konkurrencës është një nga gurët përbërës të mjedisit ekonomik të shëndetshëm. N.q.s ajo është formuluar dhe implementuar në mënyrën e duhur, ajo krijon një mjedis ekonomik të qëndrueshëm dhe transparent për investitorët dhe siguron që ndërveprimi midis operatorëve ekonomikë është eficient dhe mirëqenia është maksimizuar.

Qëllimi i politikës së konkurrencës është pikërisht të inkurajojë eficientë ekonomike. Konkurrenca në treg mbron interesat e konsumatorit dhe suporton konkurrueshmërinë. Politika e konkurrencës ka për qëllim të sigurojë që konkurrenca nuk është kufizuar nga praktikant anti-konkurrese të firmave të ndryshme. Politika kombëtare e konkurrencës në Shqipëri synon të ndërtojë një urë komunikimi me publikun dhe institucionet shtetërore.

Objektivi kryesor i Politikës Kombëtare të Konkurrencës në Shqipëri është zhvillimi i një tregu konkurrues, me qëllim që të nxisë përdorimin eficient të burimeve, dhe që të mbrojë lirinë e veprimtarisë ekonomike të pjesëmarrësve të ndryshëm në treg. Me qëllim që të integrohemi në hapësirën evropiane, nevojitet të kemi një “treg të brendshëm konkurrues”. Për këtë arsye i kushtohet një rëndësi e veçantë politikës kombëtare të konkurrencës si një drejtim tepër i fortë kundrejt fiksimit të çmimeve, karteleve të ndarjes së tregjeve, abuzimeve me pozitën dominuese dhe përqendrimeve anti konkurruese. Gjithashtu, ndalohen të drejtat e monopoleve shtetërore të pajustificuara të cilat shtrembërojnë konkurrencën duke i mbajtur artificialisht në treg.

Politika Kombëtare e Konkurrencës ka objektiv gjithashtu futjen në tregun e vetëm evropian sipas detyrimeve që rrjedhin nga MSA; rritjen e standardit të mirëqenies; mirëqenien e konsumatorit; të mbrojë lirinë e veprimtarisë ekonomike të pjesëmarrësve në treg; të reduktojë barrierat e hyrjes në treg me qëllim që të krijohet një mjedis i përshtatshëm për nxitjen e sipërmarrjes dhe rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; të ruajë ndershmërinë dhe korrektësinë në marrëdhëniet me biznesin.¹⁰

Politika e Konkurrencës në Evropë shihet si guri i katërt i themelit të kuadrit të politikave ekonomike të qeverisë, së bashku me politikat monetare, fiskale dhe ato tregtare. Në këtë

¹⁰ Competition law and industrial policy in EU. Wolf Sauter

këndvështrim, ajo është një nga elementët thelbësorë që përbëjnë themelin për krijimin e tregut të brendshëm. Pa një sistem dhe një institucion përkatës, i cili të sigurojë që konkurrenca në tregun e përbashkët nuk është shtrembëruar, tregu i brendshëm nuk do të mund të funksiononte.

6. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit: një Marrëveshje asimetrike

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian mund të realizohet vetëm me anë të zbatimit të një marrëveshje paraprake, e cila parashikon përshkrimin e disa etapave progresive deri në arritjen e qëllimit final: anëtarësimin në BE. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është marrëveshja më e rëndësishme kontraktuale që Shqipëria ka me Bashkimin Evropian. Ajo përbën mjetin kryesor për monitorimin e reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare në kuadër të integrimit të vendit në BE. Çdo hap i mëtejshëm, në kuadër të forcimit të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe BE është i lidhur drejtpërdrejt me vlerësimin e zbatimit efektiv të kësaj Marrëveshjeje. Komuniteti Evropian ka nënshkruar marrëveshje të tilla me Maqedoninë, Kroacinë, Serbinë, Malin e Zi dhe Bosnje Hercegovinën.

Qëllimi kryesor i kësaj Marrëveshje është nga njëra anë forcimi i marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Evropian, deri në anëtarësimin e saj dhe nga ana tjetër, të mos cenohet themelet e ndërtesës evropiane duke pasur si element thelbësor të saj zbatimin e legjislacionit evropian/“*acquis communautaire*”.

Elementët thelbësorë, të kësaj Marrëveshje janë: (i) ajo përbën një mjet i cili siguron, ngjashmërisht me Marrëveshjet e Evropës për vendet e Evropës Qendrore, mekanizmat formalë dhe metodat e bashkë-pranuara që lejojnë BE-në të punojë me secilin vend për t’u sjellë më pranë standardeve të zbatueshme në BE, (ii) ajo është një mjet që shërben për të fokusuar vëmendjen në respektin për parimet thelbësore të demokracisë- të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, institucionet demokratike të qëndrueshme, standardet e sjelljes politike dhe pavarësisë së mediave dhe (iii) ajo përfshin elementët themelorë të cilat janë në zemër të tregut të përbashkët të BE-së. Përmes tregtisë së lirë me BE-në dhe disiplinave të bashkëshoqëruara me to (konkurrenca dhe rregullat e ndihmës shtetërore, pronësia intelektuale etj) si dhe përmes të drejtave (p.sh. profesionet), ky proces do të lejojë ekonominë e rajonit të fillojë të integrohet me ato të BE-së.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit përbëhet nga 137 Nene dhe ka si pjesë integrale pesë shtojca dhe gjashtë protokolle. Marrëveshja përbëhet nga dy elementë të rëndësishëm: (i) Stabilizimi, i cili i atribuon MSA një veçori politike, ndryshe nga marrëveshjet e tjera të asociimit dhe (ii) Asociimi, i cili kërkon adoptimin e *acquis communautaire* nga shteti i asociuar në mënyrë graduale e asimetrike. Veçoria politike e MSA nënkupton nevojshëm për vendosjen e dialogut politik të shtetit të asociuar si dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal ndërmjet vendeve të përfshira në Procesin e Stabilizim-Asociimit. Në këtë kuadër, një aspekt tjetër i kësaj Marrëveshjeje është edhe përcaktimi i kuadrit institucional.

Në Titullin X të MSA parashikohet ngritja e institucioneve, të cilat do të hartojnë politikat në kuadër të procesit të integritit dhe nga ana tjetër do të kryejnë monitorimin e tyre. Institucioni më i lartë do të jetë Këshilli i Stabilizim-Asociimit, në të cilin do të diskutohen vendimet në nivel politik. Vendimet e mara nga Këshilli do të jenë detyruesisht të zbatueshme. Këshilli ndihmohet nga një Komitet Stabilizim-Asociimi, që përbëhet nga përfaqësues të Komisionit Evropian dhe të shtetit të asociuar.

Komiteti mund të krijojë edhe nën-komitete për t'u ndihmuar në përmbushjen e detyrave të tij. Ndërsa dialogu politik në nivelin parlamentar zhvillohet në Komisionin Parlamentar të Stabilizim-Asociimit, i cili përbëhet nga anëtarë të Parlamentit Evropian dhe të parlamentit të shtetit të asociuar. Të gjithë këto institucione, pritet të ndikojnë pozitivisht në forcimin e dialogut politik, nëpërmjet shkëmbimit të pikëpamjeve, të cilat do të marrin një rëndësi të veçantë gjatë kalimit në forma të reja të integritit të Shqipërisë në BE.

Bashkëpunimi rajonal është një angazhim që vendet e rajonit marrin përsipër në favor të ruajtjes së paqes dhe të stabilitetit, si dhe të zhvillimit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë ndërmjet tyre. Për herë të parë ky instrument merr një vlerë të detyrueshme në një marrëveshje asociimi. Dispozitat, të cilat përcaktojnë bashkëpunimin rajonal, shprehen në Titullin III i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Ndërkohë që rëndësi këtij procesi i jepet edhe në Nenet 1, 3 dhe 4 të MSA, ku duket qartë se një nga objektivat e Marrëveshjes është zhvillimi i bashkëpunimit rajonal në të gjitha fushat e mbuluara nga marrëveshja, kryesisht në çështjet që kanë të bëjnë me paqen. Shteti i asociuar ka si detyrë të marrë të gjitha masat e nevojshme për të vendosur një bashkëpunim rajonal të vërtetë.

Neni 13 përcakton se: shtetet të cilët kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit duhet të fillojnë negociimet për të nënshkruar marrëveshje me fqinjët e tyre në rajon dhe objektivat

kryesore të këtyre marrëveshjeve do të jenë dialogu politik, vendosja e një zone tregu të lirë në përputhje me parimet e OBT-së, lëshime reciprokë me qëllim realizimin e katër lirive, si dhe një bashkëpunim në fushat e tjera të mbuluara nga marrëveshja. Bashkëpunimi rajonal konsiderohet si instrumenti i duhur për eliminimin e konflikteve në rajon dhe zhvillimin e një zone sigurie dhe të qëndrueshme. Marrëveshjet e nënshkruara në këtë kuadër do t'u lejojnë këtyre vendeve të zbatojnë rregullat e një tregu të hapur, i mbështetur në struktura të shëndetshme dhe respektues i rregullave të konkurrencës së lirë.

Një element shumë i rëndësishëm i MSA është plotësimi i kriterit të tretë të Kopenhagenit: adoptimi i *acqui communautaire* dhe forcimi i kapaciteteve institucionale me qëllim zbatimin e tij. Detyrimi i palës shqiptare për përafrimin e legjislacionit shprehet në Nenin 70 të MSA. Integrimi ekonomik i shtetit të asociuar në Komunitet bën të domosdoshëm përafrimin e legjislacionit ekzistues dhe të ardhshëm të këtij shteti me atë të Komunitetit. Ky përafrim i legjislacionit do të bëhet në dy faza dhe do të kryhet brenda një periudhe kohe 10 vjeçare që nga hyrja në fuqi e MSA. Secila fazë do të zgjasë 5 vjet. Faza e parë do të mbulojë përafrimin e legjislacionit në fushat lidhur me konkurrencën, me pronësinë intelektuale, me prokurimet publike, me standardizimin dhe certifikimin e produkteve.

Faza e dytë e periudhës së tranzicionit do të mbulojë fushat e tjera, të cilat nuk përfshihen në fazën e parë. Një program i detajuar do të hartohet nga palët për realizimin e procesit të përafrimit të legjislacioneve. Shtetet kandidatë për aderim në

BE duhet të adoptojnë gjithçka që është realizuar në kuadrin e Bashkimit Evropian. Ata duhet t'u përgjigjen detyrimeve që rrjedhin nga krijimi i tregut të përbashkët si dhe politikave mbështetëse. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është një urë që çon drejt aderimit të plotë në BE dhe si e tillë ajo u imponon shteteve të asociuara të integrojnë në sistemet e tyre juridike *acquis*.

Përveç kriterit politik dhe atij të adoptimit të legjislacionit evropian, një pjesë shumë e rëndësishme e MSA-së është edhe përcaktimi i disa dispozitave ekonomike dhe tregtare, realizimi i të cilave është i lidhur ngushtësisht me plotësimin e kriterit të parë të Kopenhagenit: kriterin Ekonomik. Në thelb të këtyre neneve është domosdoshmëria për krijimin e një ekonomie tregu të aftë, të tillë që të mund të bëjë ballë presionit që vjen nga konkurrenca në tregun e brendshëm të BE. Këto nene parashikojnë kushte të përbashkëta të zbatueshme për palët, të cilat kanë të bëjnë me liberalizimin e shkëmbimeve të mallrave, shërbimeve e kapitaleve, me lirinë e qarkullimit të

personave, me përafrimin e legjislacionit si dhe me bashkëpunimin në disa fusha prioritare për zhvillimin e vendit.

Liberalizimi i shkëmbimeve tregtare qëndron në thelb të MSA-së, ku parashikohet se për vendosjen graduale të një zone tregtie të lirë palët angazhohen të eliminojnë detyrimet doganore, kufizimet sasiore dhe masat me efekt të njëjtë me to si dhe të ndalojnë adoptimin e barrierave të reja tregtare në përputhje me dispozitat përkatëse të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT). Neni 33 i MSA-së lidhet me të ashtuquajturën klauzola “*standstill*”, e cila parashikon ndalimin në parim të përfshirjes së çdo detyrimi të ri doganor, kufizimi sasior ose të një mase me efekt të njëjtë në marrëdhëniet tregtare midis Komunitetit dhe shtetit të asociuar. Dispozita të ngjashme me këto janë parashikuar dhe në fushën fiskale për taksat e brendshme, të cilat kërkojnë respektimin e parimit të mos-diskriminimit ndërmjet prodhimeve të palëve kontraktuese.

Nga ana tjetër MSA nuk pengon ruajtjen ose vendosjen e bashkimeve doganore, të zonave të tregut të lirë ose regjimeve të tregtisë kufitare të ndryshme të vendosura nga shtetet e asociuara me vendet e tjera, me kufizimin e vetëm të mos cenimit të regjimit të shkëmbimeve të parashikuar nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit. Liberalizimi i shkëmbimeve tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe BE ka filluar të zbatohet që nga 1 Dhjetori i vitit 2008, për të gjithë mallrat, përveç atyre, të cilat në Marrëveshje konsiderohen si sensitive. Shkëmbimi i lirë i mallrave plotëson një ndër katër liritë e tregut të brendshëm. Një element shumë i rëndësishëm sa i përket qarkullimit të mallrave është edhe garantimi i sigurisë së tyre. Mallrat duhet të jenë të shoqëruara me certifikatën e cilësisë, sipas kriterëve të parashikuara në Direktivën 98/34 EK.

Liria e qarkullimit të personave, të shërbimeve dhe të kapitaleve përbëjnë tre liritë e tjera të tregut të brendshëm, pa realizimin e të cilave ai nuk do të ekzistonte. Vendosja dhe realizimi i plotë i tregut të lirë ndërmjet palëve të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit nuk kërkon vetëm respektimin e lirisë së qarkullimit të mallrave, por edhe respektimin e tre lirive të tjera, që karakterizojnë hapësirën evropiane. Këto janë: liria e qarkullimit të personave, të shërbimeve dhe kapitaleve. Me qëllim realizimin e këtyre lirive Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parashikon një regjim të përgjithshëm të ushtrimit të këtyre lirive, zbatimi i të cilave për një periudhë transitorë varet ende nga vullneti i mirë i shteteve anëtare të BE-së. Nga ana tjetër, realizimi i këtyre lirive iu nënshtrohet përjashtimeve për arsye të rendit, sigurisë dhe shëndetit publik. Nga ana tjetër Neni 36 dhe 61 i MSA përcakton se masat mbrojtëse janë gjithmonë një mundësi përjashtimi nga ushtrimi i këtyre lirive.

Sa i përket lirisë së qarkullimit të punonjësve, në Nenin 34 të MSA parashikohet parimi i trajtimit kombëtar, sipas të cilit punonjësi, shtetas i shtetit të asociuar, ligjërisht i punësuar në territorin e një Shteti anëtar duhet të trajtohet njësoj si shtetasi i po këtij shteti anëtar për sa u përket kushteve të punës, të pagës ose të pushimit nga puna. Përveç shtetasit të punësuar të drejtën për integrim social dhe trajtim të njëjtë e kanë edhe pjesëtarët e familjes së punonjësit. Megjithatë kjo e drejtë nuk u njihet punonjësve sezonalë ose atyre të ardhur në bazë të një marrëveshje bilaterale, ashtu si

e parashikon neni 46 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Neni 63 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përveç derogimeve të justifikuara për arsye të rregullit publik, të sigurimit ose të shëndetit publik parashikon përjashtimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ushtrimin e funksioneve publike nga e drejta e qarkullimit të lirë të punonjësve. Gjithsesi, aksesit për punësim i punonjësve shqiptarë në tregun komunitar mbetet nën kompetencën e shteteve anëtare të BE-së, të cilët do të njohin lirinë e qarkullimit të punonjësve me anë të marrëveshjeve bilaterale të nënshkruara me Shqipërinë. Arsyeja e këtij kufizimi është fakti që punonjësit shtetas të shtetit të asociuar mund të pranojnë të punojnë në kushte financiare dhe sociale më të ulëta se punonjësit e vendit komunitar, duke shkaktuar atë që njihet si “dumping social”.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit njeh një të drejtë qëndrimi të kufizuar (a), e cila ka si qëllim të nxisë investimet në vendin e asociuar (b), por që bie në kundërshtim me dumping-un social (c). Në Komunitet, përfituesit e së drejtës së qëndrimit janë personat fizikë dhe juridikë dhe kjo e drejtë realizohet me anë të ushtrimit të një aktiviteti afatgjatë profesional në një vend anëtar si i vetëpunësuar, ose duke krijuar apo drejtuar një ndërmarrje, një filial apo degë. Dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit lidhur me të drejtën e qëndrimit kanë të bëjnë vetëm me shoqëritë dhe shtetasit, që kanë të drejtë të krijojnë shoqëri. Në parim shoqëritë, filialet ose degët e shoqërive shqiptare apo komunitare gëzojnë një trajtim jo diskriminues menjëherë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Klauzola e “standstill” vepron gjithashtu duke ndaluar marrjen e masave të tjera diskriminuese.

Këto rregulla janë të detyrueshme si për Komunitetin ashtu dhe për Shtetet anëtare. Kjo do të thotë që personat juridikë shqiptarë gëzojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit të drejta më të gjera sesa personat fizikë. Bazuar në Nenin 55 të MSA, Komuniteti kërkon që shoqëritë e shtetit të asociuar që vendosen në territorin e një shteti anëtar, të mos ndjekin praktika dumpingu shoqëror duke përfituar nga pagat e ulëta të punonjësve të shtetit të asociuar. Kështu, këto

shoqëri nuk mund të punësojnë shtetas të shtetit të asociuar në territorin e Komunitetit, përveçse kur këta bëjnë pjesë në “personelin bazë” të shoqërisë sipas marrëveshjes. Me këtë kuptojmë pikërisht funksionarët e lartë që drejtojnë firmën, ose punonjësit me kualifikim të lartë. Kjo dispozitë ka një karakter reciprok. Nga njëra anë ajo ka si synim mbrojtjen e tregut të punës dhe, nga ana tjetër, kufizimin e migracionit të punonjësve.

Sa i përket ofrimit të shërbimeve, palët angazhohen të marrin masat e nevojshme për të lejuar progresivisht ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë ose shtetasit e vendeve anëtare të BE-së ose të shtetit të asociuar të vendosur në një territor të ndryshëm nga marrësi i shërbimit. Zbatimi i kësaj dispozite, siç e ka treguar dhe funksionimi i tregut të përbashkët, nga njëra anë kërkon shpeshherë një harmonizim normativ kompleks, dhe nga ana tjetër, sektori i shërbimeve gjeneron një pjesë të madhe të punësimit kështu që një liberalizim i pakontrolluar do të kishte pasoja të rëndësishme në tregun e punës, sidomos në atë të shtetit të asociuar. Kufizimet e lejuara janë po ato që parashikohen dhe për liritë e tjera të përshkruara më sipër (rendi publik, siguria publike dhe shëndeti publik).

Liria e qarkullimit të kapitaleve është një vijim i lirisë së qarkullimit të mallrave dhe të qëndrimit. Komuniteti dhe shteti i asociuar duhet të sigurojnë lirinë e qarkullimit të kapitaleve lidhur me investimet direkt, si dhe riatdhesimin e të ardhurave të këtyre investimeve. E njëjta liri gjen zbatim edhe në lidhje me pagesat e transaksioneve tregtare ku marrin pjesë persona juridikë ose fizikë nga shteti i asociuar, ose shtetet anëtare të BE-së. Të dyja palët janë angazhuar të mos marrin kufizime të reja në shkëmbimet që prekin lëvizjet e kapitaleve. Përveç kufizimeve të justifikuar nga interesat e shtetit, mund të merren edhe masa mbrojtëse në rast vështirësish të mëdha për bilancin e pagesave.

Me qëllim “vënien në jetë” dhe funksionimin siç duhet të katër lirive të tregut të brendshëm, një prioritet kyç është përafrimi i legjislacionit në fushat kyçe të tregut, kryesisht ato që lidhen me shkëmbimet tregtare dhe dispozitat ekonomike. Një vend të rëndësishëm në këtë fushë zënë rregullat e konkurrencës. Me qëllim realizimin e qarkullimit të lirë të mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitaleve, marrëveshja parashikon vendosjen e rregullave të një konkurrence të ndershme. Neni 71 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit parashikon që praktika të tilla si marrëveshjet ndërmjet operatorëve ekonomikë që kufizojnë konkurrencën ose abuzimet e pozicioneve dominuese do të vlerësohen mbi bazën e kritereve që rrjedhin nga zbatimi i neneve 81, 82 dhe 87 i TKE-së.

Këtyre rregullave do t'u nënshtrohen si sjelljet e operatorëve ekonomikë ashtu dhe veprimet e shteteve që mund të ndikojnë tregtinë midis palëve. Këtij qëllimi i shërben dhe angazhimi i marrë nga palët për të rregulluar progresivisht monopolet shtetërore me karakter tregtar me qëllim eliminimin e çdo diskriminimi në fushën e furnizimit dhe të tregtimit të mallrave, në përputhje me Nenin 37 të TKE. Nga ana tjetër me qëllim rregullimin e tregut, nevojitet zbatimi i politikës anti-dumping. Eksporti i një produkti me një çmim më të ulët se çmimi i këtij produkti ose i një produkti të ngjashëm me të në tregun e brendshëm do t'u lejonte vendeve eksportuese të konkurronin në mënyrë jo të ndershme me vendet importuese, duke kërcënuar kështu zhvillimin në fushën ekonomike të këtyre vendeve. Pala, që konsiderohet si viktimë e praktikave të dumping-ut mund të marrë masat e duhura kundër këtyre praktikave, por duke njoftuar Këshillin e Stabilizim-Asociimit.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, përveç detyrimit për përafrimin e legjislacionit dhe masave që duhen marrë për garantimin e katër lirive të tregut të brendshëm, parashikon gjithashtu edhe masat që duhen ndërmarrë me qëllim forcimin e bashkëpunimit në fushat prioritare. Dy janë elementët kryesorë të këtyre dispozitave. Nga njëra anë ato kanë të bëjnë me bashkëpunimin në fushën e drejtësisë dhe të çështjeve të brendshme dhe nga ana tjetër, me bashkëpunimin në politikat sektoriale. Dispozitat, të cilat parashikojnë bashkëpunimin në fushat e drejtësisë dhe të çështjeve të brendshme e bëjnë MSA-në të veçantë në raport me Marrëveshjet që BE ka nënshkruar me vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore.

Ky bashkëpunim kërkon që shteti i asociuar të forcojë institucionet në çdo nivel, por në veçanti ato që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe administrimin e drejtësisë. Përpjekjet e Shqipërisë duhet të fokusohen në përmirësimin e regjimit juridik të vizave, azilit dhe migracionit, në luftën kundër krimit të organizuar nëpërmjet bashkëpunimit policor dhe bashkëpunimit gjyqësor. Ndërsa bashkëpunimi në politikat sektoriale ka si objekt përkrahjen dhe zhvillimin e shtetit të asociuar dhe forcimin e marrëdhënieve ekonomike ekzistuese midis palëve. Këto politika zënë vend në një kuadër rajonal bashkëpunimi. Të krijohet përshtypja se nëpërmjet Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Komuniteti vë në zbatim Titullin XX të pjesës së tretë të TKE-së i titulluar “ Bashkëpunim për zhvillim ” (nenet 177-181).

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parashikon vendosjen e një zone tregtie të lirë mes Komunitetit Evropian dhe Shqipërisë, që do të thotë se palët do të krijojnë një hapësirë të përbashkët ku mallrat do të qarkullojnë lirshëm, pa barriera fizike dhe teknike. Për të përfutur

nga regjimi i qarkullimit të lirë të mallrave të rregulluar nga marrëveshja, produktet duhet të jenë me origjinë nga njëra ose tjetra palë, pra të jenë produkte të prodhuara plotësisht ose të transformuar në mënyrë të mjaftueshme në shtetin eksportues. Duke pasur parasysh konkurrencën e dobët të produkteve origjinale të shtetit të asociuar, një hapje brutale e tregut të këtij të fundit menjëherë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit do të kishte pasoja të dëmshme për ekonominë e shtetit të asociuar. Aksesit i menjëhershëm i importeve komunitare do të shkaktonte rrënimin e disa ndërmarrjeve të vendosura në territorin e shtetit të asociuar, gjë që mund të sillte probleme sociale.

Duke pasur parasysh se qëllimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është vendosja e stabilitetit politik dhe ekonomik në Shtetin e asociuar, tregu i përbashkët parashikohet të realizohet gradualisht dhe në mënyrë asimetrike, gjë që përbën ndoshta veçorinë më karakteristike të saj. Zbatimi asimetrik i detyrimeve që parashikon Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ka të bëjë, nga njëra anë, me qarkullimin e lirë të mallrave dhe, nga ana tjetër, me fushat kyçe të lidhura me zbatimin e kësaj lirie. Një aspekt tjetër i asimetrisë së zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është dhe asistenca financiare e akorduar nga Komuniteti Evropian me qëllim realizimin e objektivave të saj.

Në tregun e përbashkët evropian realizimi i lirisë së qarkullimit të mallrave kërkon heqjen e detyrimeve doganore si dhe detyrimet me pasoja të njëjta, të kufizimeve sasiore si dhe çdo masë me pasoja të njëjta. Duke ndjekur të njëjtat parime thelbësore për vendosjen e një zone tregu të lirë mes palëve, marrëveshja parashikon se të gjitha detyrimet doganore, kufizimet sasiore si dhe të gjitha masat me pasoja të njëjta që pengojnë qarkullimin e lirë të mallrave ndalohen që me hyrjen në fuqi të marrëveshjes *ad interim* ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian. Për arsytet e lartpërmendura, këto rregulla njohin përjashtime të mëdha, të cilat figurojnë në mënyrë të qartë në anekset dhe protokollat që i bashkëngjiten Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Për të vendosur zonën e tregtisë së lirë Komuniteti Evropian-shteti i asociuar gjatë një periudhe dhjetë vjeçare, liberalizimi tarifor është parashikuar me ritme të ndryshme sipas kategorive të produkteve të parashikuara, industriale, apo bujqësore.

Përveç liberalizimit doganor asimetrik, Komuniteti bën lëshime dhe në fushat kyçe të realizimit të tregut të përbashkët, kryesisht në fushën e konkurrencës, liberalizimin e tregut të tokës, ndihmave shtetërorë dhe prokurimet publike. Këtu do të trajtojmë kryesisht lëshimet për ndihmat publike dhe prokurimet si çështje sensibil të politikave të mbrojtjes. Në fushën e ndihmave

shtetërore, Komuniteti autorizon shtetin e asociuar të akordojë ndihma të cilat, për një periudhë tranzitore të rënë dakord nga palët, do t'i konsiderojë si ndihma që kanë si qëllim favorizimin e zhvillimit ekonomik në rajonet ku niveli i jetesës është jashtëzakonisht i ulët ose ku ka një papunësi të konsiderueshme. Qëllimi i kësaj dispozite është zvogëlimi i diferencave ekonomiko shoqërore ndërmjet shtetit të asociuar dhe Bashkimit Evropian.

Ndihma shtetërore do të vlerësohet në bazë të parimit të ekuilibrit ndërmjet shtrembërimit të konkurrencës që shkakton ndihma dhe avantazheve që sjell për rajonin e defavorizuar. Aksesit në prokurimet publike parashikohet gjithashtu në mënyrë asimetrike. Shoqëritë e Komunitetit të pavendosura në Shqipëri do të gëzojnë një akses të lirë në prokurimet publike në Shqipëri vetëm pas një periudhe të rënë dakord nga palët gjatë negociatave pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Shoqëritë e shtetit të asociuar e fitojnë të drejtën e aksesit në prokurimet publike të Komunitetit menjëherë me hyrjen në fuqi të marrëveshjes. Ristrukturimi i ekonomisë së shtetit të asociuar do të sjellë shumë punime publike për infrastrukturën dhe ndërmarrjet e shtetit të asociuar do të kenë prioritet për të marrë pjesë në to. Ky fenomen do të kontribuonte për zhvillimin e ndërmarrjeve të shtetit të asociuar dhe rrjedhimisht aftësisë së tyre konkurruese në tregun rajonal e evropian, rritjen e investimeve si dhe të prodhimit në vend.

Me qëllim mbështetjen e reformave, në Titullin IX të MSA parashikohet vazhdimi i ndihmës financiare për Shtetin e asociuar me qëllim që ky i fundit të arrijë objektivat e vendosura nga marrëveshja. Aktualisht Shqipëria po përfiton nga Instrument i Para Aderimit 2007-2013 (IPA). Bashkëpunimi financiar do të mund të mbështesë reformat demokratike, ekonomike dhe institucionale të Shtetit të asociuar në përputhje me procesin e stabilizimit dhe të asociimit. Ai mund të jetë i dobishëm për aspektet e ndryshme të harmonizimit të legjislacionit dhe të politikave të bashkëpunimit të parashikuara nga marrëveshja. Nga ana e vet, shteti duhet të zhvillojë aftësitë e tij për të koordinuar ashtu si duhet ndihmat e BE-së dhe për t'i përdorur ato në mënyrë efikase.

7. Konkurrenca si një faktor i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në BE

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit, Shqipëria ka hyrë në një fazë të re të partneritetit me Bashkimin Evropian. Kjo fazë kërkon zbatimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, detyrime të cilat nuk janë gjë tjetër veçse zërthimi i tre kritereve të Kopenhagenit: kriterin politik, ekonomik dhe atë të legjislacionit. Kriteri ekonomik kërkon që Shqipëria të zhvillojë një ekonomi tregu, të aftë për ti ballë konkurrencës së tregut të brendshëm të Bashkimit Evropian. Në funksion të krijimit të një ekonomie të tillë, konkurrenca mund të konsiderohet si elementi themelor.

Çështjet e konkurrencës mbeten tejet të rëndësishme për tregun e përbashkët evropian dhe vendet anëtare. Realizimi i tregut të brendshëm bazohet tek konkurrenca midis prodhuesve të mallrave dhe shërbimeve. Politika e konkurrencës është konsideruar gjithmonë e domosdoshme në nivelin komunitar me qëllim që të favorizojë efektshmërinë ekonomike dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, të cilët mund të përfitojnë në këtë mënyrë të mira dhe shërbime në kushte më të mira. Kjo politikë është përcaktuar që në fillim në Traktatin e Romës dhe mund të konsiderohet si një nga politikat më të rëndësishme të Komunitetit. Politika evropiane e konkurrencës zhvillohet në pesë drejtime:

- Ajo ka për objektiv të *eliminohet monopolizimin e disa tregjeve* duke ndaluar që ndërmarrjet, me anë të marrëveshjeve proteksioniste, të ndajnë tregun mes tyre. Neni 81 i Traktatit i ndalon marrëveshjet dhe praktikatat e rregulluara bashkërisht midis ndërmarrjeve, të cilat mund të prekin tregtinë midis shteteve anëtare dhe që kanë si objektiv ose që sjellin pengimin, kufizimin apo prishjen e lojës së konkurrencës brenda tregut të përbashkët. Në marrëveshjet e ndaluara bëjnë pjesë gjithashtu marrëveshjet që caktojnë direkt ose indirekt çmimet, marrëveshjet mbi kushtet e shitjes, përcaktimin e kuotave të prodhimit, marrëveshjet që ndajnë tregjet apo burimet e financimit etj. Gjithsesi disa tipe bashkëpunimesh të konsideruar pozitive, mund të autorizohen nga Komisioni në momentin që ato lejojnë përmirësimin e prodhimit dhe të shpërndarjes, ose kur ato promovojnë progresin teknik ose ekonomik (për shembull marrëveshjet e ekskluzivitetit, marrëveshjet që lejojnë transferimin e teknologjisë, marrëveshjet e specializimit apo ato të zhvillimit dhe marrëveshjet kërkimore). Komisioni ka të drejta të shumta për të hetuar mbi ndërmarrjet e dyshimta për praktika monopoliste. Në fund të një

procedure që i jep ndërmarrjes mundësinë për tu mbrojtur Komisioni mund të kërkojë që ti jepet fund praktikës në fjalë. Ai gjithashtu mund të imponojë gjoba në shumën 10% të xhiros vjetore. Ndërmarrja mund të bëjë një ankim pranë Gjykatës së Drejtësisë, por përgjithësisht Komisioni dhe Gjykata ndjekin të njëjtat orientime.

- Politika evropiane e konkurrencës synon të *mënjanojë abuzimin e pozicionit dominues*. Një pozicion dominues është një situatë supremacie ekonomike që i lejon një ose shumë ndërmarrjeve të pengojnë mbajtjen e një konkurrence të vërtetë në treg dhe ka abuzim të pozicionit dominues kur qëndrimi i kësaj ndërmarrjeje mund të influencojë mbi strukturën ose shkallën e konkurrencës në treg. Në rastet e abuzimit të pozicionit dominues Komisioni ndërhy.
- Për të *mënjeluar krijimin e pozicioneve dominuese*, përqendrimet e ndërmarrjeve kontrollohen kur bëhet fjalë për ndërmarrje mbi një masë të caktuar dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre në shumë shtete anëtare. Këto përqendrime duhet të deklarohen në Komision, i cili mund ti ndalojë kur ato krijojnë ose përforcojnë një pozicion dominues nga i cili rrjedhin pengesa të rëndësishme për një konkurrencë të vërtetë. Ndalime të tilla bëhen rrallë, por ato përbëjnë një kërcënim të dobishëm. Bashkimet e ndërmarrjeve janë shumëfishuar që prej viteve '80 dhe sidomos '90, janë bërë shpesh të nevojshme për të përballuar konkurrencën ndërkombëtare.
- Politika e konkurrencës ka gjithashtu si objektiv të *ndalojë ndihmat publike që tjetërsojnë konkurrencën* duke favorizuar disa ndërmarrje apo disa prodhime. Megjithatë Traktati parashikon përjashtime të ndryshme, veçanërisht për ndihmat e caktuara për promovimin e zhvillimit ekonomik të disa aktiviteteve apo disa rajoneve. Për çdo ndihmë apo regjim ndihmesh duhet të njoftohet Komisioni dhe ai duhet ta aprovojë atë para se ajo të jetë hedhur për ekzekutim. Edhe sot Komisioni dhe Këshilli kanë si detyrë të zvogëlojnë nivelin e përgjithshëm të ndihmave publike dhe të mos lejojnë që këto ndihma të tjetërsojnë konkurrencën, duke privilegjuar objektivat horizontale si përkrahja ekonomike dhe sociale.

Rregullat e konkurrencës zhvillohen si në ndërmarrjet publike ashtu edhe në ato të cilave shtetet anëtare u japin të drejta të veçanta dhe ekskluzive. Sipas Nenit 86 të Traktatit ndërmarrjet e

ngarkuara për administrimin e një shërbimi me interes ekonomik të përgjithshëm apo që paraqesin karakterin e një karakterin e një monopoli fiskal, u nënshtrohen rregullave të konkurrencës deri në masën që zbatimi i këtyre rregullave nuk lejon përmbushjen, sipas të drejtës apo praktikës, të misionit të veçantë që u është ngarkuar bashkërisht.

Komisioni dhe gjykatat evropiane e zbatojnë ligjin dhe politikën e konkurrencës gjithmonë duke pasur parasysh funksionimin e një tregu të vetëm. Procesi i anëtarësimit të dymbëdhjetë shteteve të reja si dhe negociatat me shtetet e tjera kandidate dhe kandidate potenciale, kanë treguar se edhe për politikën e konkurrencës, çështja thelbësore është Integrimi Evropian.

Për të lehtësuar procesin e integritit evropian, Bashkimi Evropian e konsideron të nevojshme dhe të domosdoshme që, duke filluar nga dita e parë e hyrjes në bashkësinë evropiane, të gjitha shtetet kandidate të njohin e të zbatojnë kuadrin ligjor në fuqi. Ekonomitë e shteteve anëtare duhet të fillojnë të funksionojnë brenda një kuadri të pranueshëm rregullator, që ndalon zhvillimin e tregjeve kundër interesave të vetë vendeve të asociuara dhe krijimin e strukturave të monopolizuara dhe jo-eficente. Në këtë mënyrë, një politikë aktive konkurrence do të ndihmonte në procesin e tranzicionit, duke krijuar struktura të shëndetshme ekonomike dhe duke shmangur përfitimet antiligjore dhe jo normale.

Është e rëndësishme që procesi i përafrimit, i përcaktuar në marrëveshjet evropiane, të vazhdohet në të gjitha fushat e politikës së konkurrencës. Marrëveshjet nuk kërkojnë detyrimisht përshtatjen e plotë të “*acquis communautaire*” në fushat respektive dhe me të gjitha hollësitë, por është e detyrueshme që të harmonizohen parimet bazë, brenda një kuadri të përshtatshëm strukturor. Duhet të theksojmë se procesi i integritit nuk është i kufizuar vetëm në përshtatjen e ligjeve dhe të rregulloreve ose në ndërtimin e strukturës.

Përpjekje të vazhdueshme duhet të bëhen për të siguruar zbatimin e politikës, për ta bërë atë të njohur publikisht dhe për ta pranuar nga të gjithë aktorët ekonomikë të përshtirë në proces pra, për qeveritë, ndërmarrjet dhe shoqatat e tyre si dhe sigurisht për konsumatorin. Tregu më i gjerë pranohet nga të gjithë lojtarët, vetëm nëse përcaktohen rregulla loje të barabarta dhe kërkohet zbatimi efektiv i tyre. Dështimi në këtë aspekt, do të sillte konflikte të cilat sigurisht që do të çonin në rishfaqjen dhe rivendosjen e kufijve dhe masave mbrojtëse të shteteve anëtare karshi njëra tjetrës.

Detyrimi i palës shqiptare është njohja dhe përafrimi i standardeve evropiane në politikën e brendshme të konkurrencës. Këto detyrime janë parashikuar në Nenet 70 dhe 71 të MSA,

rekomandimet që rrjedhin nga Raport Progresi Vjetori i KE dhe prioritetet e Dokumentit të Partneritetit Evropian. Detyrimet themelore në këtë fushë janë përafrimi i mëtjshëm i legjislacionit, forcimi i autonomisë së Autoritetit të Konkurrencës si dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe teknike në këtë fushë me qëllim zbatimin e rregullave të lojës së ekonomisë së tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Në Raport Progresin Vjetor të KE të vitit 2007 janë mirëpritur zhvillimet e fundit në këtë fushë. “Janë shënuar disa përparime në fushën e antitrust. Është miratuar një politikë për konkurrencën e cila do të shërbejë si një guidë për ngritjen e tregut të lirë dhe efikas të konkurrencës, ku prioritetet janë telekomunikacionet, energjia dhe shërbimet financiare. Është rritur numri i stafit në 35 punonjës. Është miratuar struktura e re. Është kontribuar në drejtim të promovimit të kulturës së konkurrencës.” Ndërsa prioritetet e Dokumentit të Partneritetit Evropian për konkurrencën janë:

- Të përmirësohet dhe të përafrohet me *acquis* legjislacioni ekzistues (antitrust) për forcimin e kontrollit mbi konkurrencën,
- Të forcohen kapacitetet administrative të Autoritetit të Konkurrencës dhe të pajiset me trajnimin dhe personelin e duhur.

Për t’ju përgjigjur realizimit të këtyre angazhimeve, Autoriteti i Konkurrencës, ka ndërmarrë disa veprime shumë të rëndësishme. Ato kanë synuar të drejtohen kah fokusit kryesor të rekomandimeve të BE: përafrimit të legjislacionit, fuqizimit të autonomisë së tij si dhe forcimit të kapaciteteve administrative. Mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive, si detyrë të vazhdueshme dhe parësore të përcaktuar nga Ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës e ka parë gjithmonë të lidhur ngushtë me përafrimin e akteve ligjore dhe nënligjore të legjislacionit vendas me aktet juridike të BE-së.

Rregulloret e përcaktuara në nenin 84 të ligjit të mësipërm e në zbatim të tij, për plotësimin e të drejtës vendase të konkurrencës, janë hartuar në përputhshmëri të plotë me aktet juridike përkatëse të BE-së. Njëkohësisht çdo akt juridik vendas, që hartohet për nevojat e kësaj të drejte, referohet gjithmonë me analogen e saj të BE-së. Përveç përafrimit të legjislacionit shumë i rëndësishëm është zbatimi i tij. Kjo kërkon ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve të tregut, për të marrë vendimet e tyre në përputhje me kuadrin ligjor të përcaktuar. Vetëm në këtë mënyrë tregu jep mundësinë e plotë të përfitimeve. Si hap i parë në këtë drejtim është paraparë përcaktimi i

procedurës që do të ndiqej për përafrimin e legjislacionit aktual dhe për këtë është hartuar Metodologjia e Përafrimit të Legjislacionit.

Kjo është parë si një detyrë e rëndësishme e Autoritetit të Konkurrencës, për të përmbushur pjesën e tij të detyrimeve që i takojnë në kuadrin e Paktit të Stabilitetit dhe Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që ka nënshkruar vendi ynë me vendet anëtare të BE-së. Këto detyra janë të përcaktuara qartë në nenet 6,40,70,71,72 të MSA-se ose dhe në nenet 27, 38, 39 të Marrëveshjes së Ndërmjetme (Interim). Në bazë të këtyre detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e mësipërme përfshi këtu edhe partneritetin evropian, Autoriteti i Konkurrencës është angazhuar që për një periudhë 2-3 vjeçare të japë rekomandimet e duhura mbi rregullimin e monopoleve shtetërore dhe të marrë masa për të shmangur diskriminimin e konkurrenteve të huaj me firmat monopoliste shtetërore. Si prioritet afatgjatë parashikohet ecja drejt vendosjes së një discipline të plotë në zbatimin e rregullave të konkurrencës në Shqipëri, për të siguruar një mjedis sa më konkurrues dhe për të rritur kulturën e konkurrencës.

Objektivi kryesor i ligjit të konkurrencës dhe i politikës së konkurrencës është efica ekonomike evropiane si dhe integrimi evropian i tregut. Politika e konkurrencës është një mënyrë për të arritur shpërndarjen optimale të burimeve, të promovohet progresi teknologjik, dhe të adoptohen drejt një mjedisi të ndryshueshëm. Puna për përafrimin e legjislacionit fokusohet kryesisht në hartimin e atyre akteve nënligjore, të cilat lidhen me futjen e koncepteve dhe procedurave evropiane që kanë të bëjnë me:

- llojet e marrëveshjeve të ndaluara,
- mënyrën e identifikimit të abuzimeve me pozitën dominuese si dhe
- llojet e procedurave për kontrollin e përqendrimeve. Këto aspekte lidhen edhe me funksionin tjetër të rëndësishëm të AK, atë të vendimmarrjes së KK, të referuar në nenin 24, germa f, të ligjit në të cilin del në pah roli rekomandues i tij. Detyrat vendimmarrëse përfshijnë jo vetëm punën përgatitore që lidhet me daljen dhe ekzekutimin e vendimeve, por edhe rëndësinë e identifikimit të AK përmes rekomandimeve që jep në mbrojtje të konkurrencës së lirë dhe efektive.

Gjate kësaj periudhe forcimi i kapaciteteve administrative ka qenë në vëmendje të Autoritetit të Konkurrencës, si nga pikëpamja e numrit dhe strukturës, ashtu edhe e formimit të tyre profesional, si faktorë bazë që sigurojnë rritjen e pavarësisë reale të këtij institucioni. Plotësimi i strukturës kryesisht me staf të ri kërkon dhe realizimin e një sërë trajnimesh si brenda ashtu dhe

jashtë vendit. Aktualisht struktura organizative e Autoritetit të Konkurrencës është miratuar nga Kuvendi me Ligjin nr. 9584, Datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese, si dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”.

KAPITULLI II

2. Kuptimi dhe çështjet teorike mbi elementet e figurës së veprës penale në konkurrencën e lirë

Nocioni i figurës ligjore i përfshin veçoritë ligjore me të cilët vepra penale përcaktohet si entitet i *posaçëm* dhe dallohet nga veprat tjera penale. Figurën ligjore e përbëjnë vetëm veçoritë e drejtuara rreth shkeljes të së *mirës juridike*.¹¹ Figura ligjore i konkretizon elementet e përgjithshme të nocionit të veprës penale sipas kriterit vlerësues të shkeljes së normës konkrete, respektivisht të së mirës juridike në mbrojtjen e së cilës është vendosur ajo.

Funksioni themelor i figurës ligjore është që ta definojë *të padrejtën objektive materiale* të veprës penale, ashtu që e njëjta nuk i përfshin elementet e fajit, i cili është *element i posaçëm subjektiv* i veprës penale. Përrjashtim paraqesin disa veçori subjektive të përfshira në figurën ligjore, nga të cilat varet e padrejta materiale e veprës penale (elementet subjektive të kundërligjshmërisë).¹² Përcaktimi i figurës ligjore dhe mënyra e përshkrimit të veçorive të saj është çështje e ligjdhënësit. Ato çdo herë janë të dhëna në formë abstrakte dhe të gjeneralizuara. Plotësimi i veçorive ligjore të veprës penale me përmbajtje konkrete lë hapësirë për interpretimin gjyqësor si fazë paraprake të *subsumimit* dhe kualifikimit juridik të ngjarjes kriminale.

Studimi i figurës ligjore ben *dallimin e elementeve objektive nga ato subjektive* të veprës penale: të parët i përkasin figurës ligjore dhe ie tregojnë kundërligjshmërinë, ndërsa të dytët hyjnë në *fajin* si element i posaçëm subjektiv të nocionit të veprës penale (përgjegjshmëria, dashja apo pakujdesja dhe vetëdija për ndalimin e veprës).¹³

Tërësia e elementeve të posaçme sajton figurën e veprës penale të caktuar.¹⁴ Elementet themelore apo të përgjithshme (veprimi i njeriut, kundërligjshmëria, etj) duhet të shprehen te çdo veprë penale, elementet e posaçme janë tipare apo karakteristikë e veprës penale të caktuar dhe këto shprehen krahas elementeve të përgjithshme. Figura e veprës penale sajohet duke përcaktuar

¹¹ Vllado.K&Ismail.Z, E drejta penale- Tetove,2018,fq.80

¹² Po aty

¹³ Po aty-veper e cituar

¹⁴ Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtine, 2016

elementet e posaçme veç e veç dhe duke bërë sintetizimin dhe përgjithësimin e tyre në dispozitën e caktuar penalo juridike.

Vepra penale e vjedhjes përbëhet prej këtyre elementeve; - marrjes - pasurisë së huaj të luajtshme dhe me qëllim që me përvetësimin e saj t'i sjell vetes ose tjetrit fitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme. Pa këto elemente të posaçme s'ka vepër penale p.sh., nëse dikush e merr automjetin e dikujt për ta vozitur nuk ka vepër penale të vjedhjes, ose kur i akuzuari me përdorimin e forcës ia merr orën të dëmtuarit që të sigurojë ardhjen e tij, nuk ekziston vepra penale e vjedhjes por vepra penale e shtrëngimit.¹⁵

Elementet e posaçme të figurës së veprës penale konkrete mund t'i referohen:

- a. kohës apo vendit të kryerjes,
- b. mënyrës apo mjetit të kryerjes,
- c. vetive personale,
- d. marrëdhënieve midis kryesit dhe viktimës etj.

3. Konkurrenca e pandershme sipas legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë

Pozita dominuese i referohet pozitës së një fuqie ekonomike që zotërohet nga një ndërmarrje e cila mundëson shtrembërimin e konkurrencës efektive që zotërohet në tregun përkatës duke i munduar atij fuqinë që të sillet në një shkallë të vlerësueshme të pavarur nga konkurrentët e tij, klientët dhe konsumatorët.

Kriteret për vlerësimin e pozitës dominuese jepen në nenin 8 të LK-së. Këto janë kritere të cilat analizojnë pozitën dominuese individuale ose të përbashkët. Analiza e studimit në një rast të tillë fillon me përcaktimin e tregut përkatës dhe vazhdon me analizën e pjesës së tregut që zotëron ndërmarrja. Në analizë merret edhe fuqia e konkurrentëve të tjerë që veprojnë në treg dhe ata që mund të hyjnë në treg në një periudhë të shkurtër kohore.

Dispozitat e LK për abuzimin me pozitën dominuese janë marrë dhe janë në përputhje të plotë me nenet e Traktatit Evropian. Në bazë të nenit 9 të LK ndalohet çdo abuzim nga një ose më shumë ndërmarrje me pozitë dominuese. Sipas parimit të abuzimit, nuk ndalohet pozita

¹⁵ Po aty

dominuose por abuzimi me këtë pozitë dominuese. Pozitë dominuese është ajo që zotërohet nga një ose më shumë ndërmarrje, dhe që i lejon ato të jenë të afta të veprojnë, për sa i përket ofertës apo kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg. (neni 9 i Ligjit të konkurrencës). Një ndërmarrje mund të zotërojë një pozitë dominuese individualisht por dy ose më shumë ndërmarrje mund të zotërojnë një pozitë dominuese të përbashkët. Një ndërmarrje e caktuar mund ta dominojë tregun kur zotëron fuqi tregu.

Për të arritur në konkluzionin për zotërimin e pozitës dominuese është e rëndësishme kryerja e analizës së plotë ekonomike duke filluar nga analiza e “pjesës së tregut përkatës të ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në shqyrtim si dhe të konkurrentëve të tjerë”. Analiza e pjesëve të tregu duhet bërë në mënyrë absolute (të ndërmarrjes që hetohet) dhe në mënyrë relative (e parë në raport me pjesët e tregut të konkurrentëve të tjerë).

Nëse një ndërmarrje ka një pjesë tregu disa herë më të madhe se konkurrenti më i afërt dhe pjesa e tregut është e shpërndarë ndërmjet disa ndërmarrjeve të vogla, atëherë ajo mund të sillet në mënyrë të pavarur ndaj këtyre konkurrentëve dhe klientëve të saj.

Aspekt i rëndësishëm në analizimin e pozitës dominuese është patjetër edhe varësia ekonomike e furnizuesve dhe blerësve. Kur këta të fundit janë të varur nga partneri tregtar, ky i fundit sillet në mënyrë të pavarur kundrejt tyre.

Për sa i përket parimit të abuzimit me pozitën dominuese, ky koncept është objektiv, sepse që një veprim i caktuar të konsiderohet si abuzim, duhet të shkelë dispozitat e nenit 9 të LK. Ligji ndërhyr në rast se ndërmarrjet e fuqishme në treg ofrojnë produkte me çmime të larta të padrejta. Vendosja e çmimeve të larta të padrejta, vijnë si rezultat i shfrytëzimit të një pozicioni ekonomik të fuqishëm siç është pozita dominuese e këtyre ndërmarrjeve.

Pasoja ose vetë objektivi i ndërmarrjeve të cilat zotërojnë pozitë dominuese (këto ndërmarrje kanë tendencën) është nxjerrja jashtë tregut e konkurrentëve të tyre ose vendosja e pengesave në hyrje të konkurrentëve të rinj në këtë treg. Një strategji që përdorin ndërmarrjet me pozitë dominuese është gjithashtu përdorimi i të ashtuquajturave çmime predatore “grabitqare”. Kjo lloj strategjie është fitimprurëse për ofruesin vetëm nëse konkurrenca dobësohet aq shumë sa ofruesi mund të rrisë çmimet më pas. Kjo do të thotë që ndërmarrja me pozitë dominuese duhet të ketë mundësinë që të rikuperojë humbjen e pësuar gjatë fazës së uljes së çmimeve (mundësia e rikuperimit).

Në praktikë, çmimet grabitqare shpeshherë nuk dallohen dot nga çmimet normale të konkurrencës. Nëpërmjet uljes së çmimeve apo përmirësimit të cilësisë së produkteve, kompania konkurren në treg dhe u sjell përfitime konsumatorëve të saj. Zakonisht firmat përdorin ulje të përkohshme çmimesh me qëllim që ti bëjnë konsumatorët sa më familjar me produktet apo edhe që të hyjnë në një treg të ri.

Çmimet grabitqare do të gjykohen si një abuzim, vetëm në rast se kompania dominuese i aplikon ato për të mbrojtur apo fuqizuar pozitën e vet dominuese. Vetëm firma dominuese mund të vendosë çmime nën koston e prodhimit me qëllim që të largojë konkurruesit e tjerë nga tregu, dhe nën të tilla kushte të tregut kompania dominuese krijon humbje.

Komisioni Evropian¹⁶ dhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë përdorin standarde të caktuar të kostove, poshtë të cilave ka më shumë arsye për të menduar që po ndodh procesi i “grabitjes.” Gjykata Evropiane ka përcaktuar kriteret për vlerësimin e grabitjes:

- Çmimet nën koston mesatare variabile duhen konsideruar gjithmonë si abuzive.
- Çmimet nën koston mesatare totale por mbi koston mesatare variabile duhen konsideruar si abuzive nëse mund të provohet qëllimi për të eliminuar.

2.1. Monopolet shtetërore

Fusha e konkurrencës është një fushë kyçe për realizimin e zonës së tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian. Për të vendosur një konkurrencë të lirë dhe të ndershme në tregun shqiptar, Shteti shqiptar është i angazhuar të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenet 27, 38 dhe 39 të Marrëveshjes së Ndërmjetme dhe në nenet 40, 70, 71 dhe 72 të MSA - së.

2.2. Ndërhyrja e Autoritetit të Konkurrencës me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg

Në bazë të ligjit, Komisioni i Konkurrencës ka kompetencë të japë vlerësime ose rekomandime për çështje që lidhen me konkurrencën dhe legjislacionin në këtë fushë. Nga njëra anë, ky aktivitet mund të influencojë procesin legjislativ dhe vendimmarrës të qeverisë dhe të

¹⁶ Bellamy and Child, Macnab, Andrew. Ros QC, Vivian. Roth, Peter. *Materials on European Community Law of Competition*

administratës qendrore dhe vendore. Për të qenë i efektshëm, vlerësimet dhe rekomandimet duhet të kërkohen dhe të merren para marrjes së vendimeve ose miratimit të projekt-ligjeve në qeveri.

Komisioni i Konkurrencës mund të japë vlerësime dhe rekomandime për çështjet që lidhen me konkurrencën e institucioneve të tjera publike, shoqatave tregtare, sindikatave, shoqatave të konsumatorit. Me anë të një kërkesë për vlerësimin e një akti normativ në stadin e projektit ose kur ky është në fuqi, këtyre institucioneve dhe organizatave u jepet mundësia të luajnë një rol aktiv dhe pozitiv për mbrojtjen dhe promovimin e konkurrencës në Shqipëri.

Për të rritur efektivitetin e vlerësimeve dhe rekomandimeve, si dhe rolin e Autoritetit në procesin ligjvënës, ndjehet e nevojshme që të përmirësohet dhe forcohet konsultimi i Autoritetit. Dy nga kriteret më të rëndësishme për të përmirësuar konsultimin e Autoritetit janë:

- konsultimi paraprak në kohë, dhe marrja në konsideratë e rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës

3. Abuzimi me pozitën dominuese

Pozita dominuese i referohet pozitës së një fuqie ekonomike që zotërohet nga një ndërmarrje e cila mundëson shtrembërimin e konkurrencës efektive që zotërohet në tregun përkatës duke i munduar atij fuqinë që të sillet në një shkallë të vlerësueshme të pavarur nga konkurrentët e tij, klientët dhe konsumatorët.

Kriteret për vlerësimin e pozitës dominuese jepen në nenin 8 të LK-së. Këto janë kritere të cilat analizojnë pozitën dominuese individuale ose të përbashkët. Analiza e studimit në një rast të tillë fillon me përcaktimin e tregut përkatës dhe vazhdon me analizën e pjesës së tregut që zotëron ndërmarrja. Në analizë merret edhe fuqia e konkurrentëve të tjerë që veprojnë në treg dhe ata që mund të hyjnë në treg në një periudhë të shkurtër kohore.

N.q.s një kompani ose grup kompanish kanë një pjesë të madhe të biznesit në një treg të veçantë, ka shumë mundësi që ato të kenë një pozitë dominuese në këtë treg. Këto lloj kompanish janë të afta dhe kanë fuqinë ekonomike të veprojnë pa u dashur të marrin në konsideratë as konkurrentët e tyre dhe sigurisht as konsumatorët.

Dispozitat e LK për abuzimin me pozitën dominuese janë marrë dhe janë në përputhje të plotë me nenet e Traktatit Evropian. Në bazë të nenit 9 të LK ndalohet çdo abuzim nga një ose më shumë ndërmarrje me pozitë dominuese. Sipas parimit të abuzimit, nuk ndalohet pozita dominuese por abuzimi me këtë pozitë dominuese. Pozitë dominuese është ajo që zotërohet nga një ose më shumë ndërmarrje, dhe që i lejon ato të jenë të afta të veprojnë, për sa i përket ofertës apo kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg. (neni 9 i Ligjit të konkurrencës). Një ndërmarrje mund të zotërojë një pozitë dominuese individualisht por dy ose më shumë ndërmarrje mund të zotërojnë një pozitë dominuese të përbashkët. Një ndërmarrje e caktuar mund ta dominojë tregun kur zotëron fuqi tregu.

Për të arritur në konkluzionin për zotërimin e pozitës dominuese është e rëndësishme kryerja e analizës së plotë ekonomike duke filluar nga analiza e “pjesës së tregut përkatës të ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në shqyrtim si dhe të konkurrentëve të tjerë”. Analiza e pjesëve të tregu duhet bërë në mënyrë absolute (të ndërmarrjes që hetohet) dhe në mënyrë relative (e parë në raport me pjesët e tregut të konkurrentëve të tjerë).

Nëse një ndërmarrje ka një pjesë tregu disa herë më të madhe se konkurrenti më i afërt dhe pjesa e tregut është e shpërndarë ndërmjet disa ndërmarrjeve të vogla, atëherë ajo mund të silltë në mënyrë të pavarur ndaj këtyre konkurrentëve dhe klientëve të saj.

Sipas eksperiencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë: Ekzistenca e pozitës dominuese mund të rrjedhë nga disa faktorë, të cilët të marrë veç e veç nuk janë domosdoshmërisht vendimmarrës, por ndërmjet këtyre faktorëve ekzistenca e një pjese të lartë tregu është shumë e rëndësishme. Faktor i rëndësishëm në përcaktimin nëse një ndërmarrje zotëron pozitë dominuese është gjithashtu analizimi i fuqisë ekonomike, e kuptuar si një nivel kapitali ose fondesh financiare të cilat mund të përdoren lirshëm nga ndërmarrja ose si lehtësi në gjetjen e fondeve në tregun e kapitaleve, mundësi këto që e vënë ndërmarrjen në një pozitë më të favorshme kundrejt ndërmarrjeve të tjera.

Ky avantazh, mundëson edhe një sjellje të pavarur të kësaj ndërmarrje në raport me klientët dhe konkurrentët e vet. Në këtë pikë duhet të kemi parasysh faktin se fuqia e një ndërmarrjeje për të prodhuar një seri produksionesh (një numër produktesh dhe shërbimesh) nuk është faktor i cili merret si bazë për të provuar ekzistencën e pozitës dominuese. Pozita dominuese, ashtu siç kemi

përmendur tek përkufizimi i tregut përkatës, vlerësohet në lidhje me një treg përkatës, dhe jo duke iu referuar të gjithë produkteve të prodhuara nga ndërmarrja në fjalë.

Sa më pak ndërmarrje të ketë në treg, d.m.th sa më i përqendruar të jetë tregu, aq më e lehtë është për ndërmarrjet që të vrojtojnë njëra tjetrën dhe ta adoptojnë sjelljen në treg. Adaptimi i sjelljes së ndërmarrjeve bëhet me i lehtë në rastin kur tregu është transparent d.m.th kur vetë tregu ofron mundësinë që ndërmarrjet të marrin lehtësisht informacion mbi vendimet e konkurrentëve.

Në rastin e pozitës dominuese shpesh hasen pengesa në hyrje. Me pengesa në hyrje do të kuptojmë vështirësitë e ndryshme që hasin ndërmarrjet për të hyrë në një treg të caktuar. Në këtë aspekt mund të përbëjnë pengesa në hyrje pengesat teknike, kostot e parikuperueshme, fuqia dhe madhësia e një ndërmarrjeje, reklama e fuqishme, të drejtat ekskluzive, posedimi i pronësisë industriale, kapaciteti i papërdorur etj.

Pengesat në hyrje lidhen me avantazhet që ka një firmë ekzistuese kundrejt firmave që mund të hyjnë në treg në të ardhmen. Këto avantazhe i lejojnë këtyre firmave që të fitojnë mbi nivelin e konkurrencës dhe në të njëjtën kohë të dekurajojnë hyrjet e reja në treg. N.q.s hyrja në treg do të ishte pa kosto dhe e menjëhershme, çmimi i tregut do të qëndronte në nivelin e situatës së dëshirueshme konkurrenciale. Si rezultat i pengesave në hyrje, pjesë të konsiderueshme të tregut, tregojnë që ndërmarrjet kanë fuqi tregu.

Aspekt i rëndësishëm në analizimin e pozitës dominuese është patjetër edhe varësia ekonomike e furnizuesve dhe blerësve. Kur këta të fundit janë të varur nga partneri tregtar, ky i fundit sillet në mënyrë të pavarur kundrejt tyre.

Për sa i përket parimit të abuzimit me pozitën dominuese, ky koncept është objektiv, sepse që një veprim i caktuar të konsiderohet si abuzim, duhet të shkelë dispozitat e nenit 9 të LK. Ligji ndërhyr në rast se ndërmarrjet e fuqishme në treg ofrojnë produkte me çmime të larta të padrejta. Vendosja e çmimeve të larta të padrejta, vijnë si rezultat i shfrytëzimit të një pozicioni ekonomik të fuqishëm siç është pozita dominuese e këtyre ndërmarrjeve.

Në këtë rast është e domosdoshme të behet krahasimi i çmimit të vënë, me vlerën ekonomike të produktit. Kur një firmë dominuese e përdor fuqinë e saj të tregut për të aplikuar çmime më të larta në mënyrë që të ketë një fitim më të madh sesa mund të pritët të ketë në një treg konkurrencial, ky quhet abuzim shfrytëzues. Zakonisht, abuzimi shfrytëzues dëmton konsumatorët, klientët apo ofruesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Gjithmonë lind pyetja se çfarë kuptohet me fitim të ndershëm të një firme. Të krahasosh çmimet e shitjes dhe koston e prodhimit do të thotë ti përgjigjes pyetjes se sa i madh do të jetë ndryshimi ndërmjet tyre, ose me fjalë të tjera sa do të jetë vlera normale e fitimit. Fitimi i madh mund të jetë një tregues i mungesës së konkurrencës, por mund të jetë edhe rezultat i investimeve paraprake të mëdha (për shembull në teknologji të re) nga firma dominuese. Sidoqoftë, fuqia ekonomike e një firme nuk mund të matet nga fitueshmëria e saj.

Në këtë rast, kur një kompani dominuese vendos çmime të larta dhe fiton me shumë, tregu mund të jete atraktiv për firmat e tjera dhe ata mund të përpiqen që të futen në këtë treg. Në rast se te tjerët mund të futen në treg dhe të fillojnë biznesin e tyre, atëherë me siguri firma dominuese do të ulë çmimet e saj. Sidoqoftë, të tjerët nuk mund të futen aq kollaj në të njëjtin treg, për shkak të barrierave të hyrjes.

Pasoja ose vetë objektivi i ndërmarrjeve të cilat zotërojnë pozitë dominuese (këto ndërmarrje kanë tendencën) është nxjerrja jashtë tregut e konkurrentëve të tyre ose vendosja e pengesave në hyrje të konkurrentëve të rinj në këtë treg. Një strategji që përdorin ndërmarrjet me pozitë dominuese është gjithashtu përdorimi i të ashtuquajturave çmime predatore “grabitqare”. Kjo lloj strategjie është fitimprurëse për ofruesin vetëm nëse konkurrenca dobësohet aq shumë sa ofruesi mund të rrisë çmimet më pas. Kjo do të thotë që ndërmarrja me pozitë dominuese duhet të ketë mundësinë që të rikuperojë humbjen e pësuar gjatë fazës së uljes së çmimeve (mundësia e rikuperimit).

Në praktikë, çmimet grabitqare shpeshherë nuk dallohen dot nga çmimet normale të konkurrencës. Nëpërmjet uljes së çmimeve apo përmirësimit të cilësisë së produkteve, kompania konkurren në treg dhe u sjell përfitime konsumatorëve të saj. Zakonisht firmat përdorin ulje të përkohshme çmimesh me qëllim që ti bëjnë konsumatorët sa më familjar me produktet apo edhe që të hyjnë në një treg të ri.

Çmimet grabitqare do të gjykohen si një abuzim, vetëm në rast se kompania dominuese i aplikon ato për të mbrojtur apo fuqizuar pozitën e vet dominuese. Vetëm firma dominuese mund të vendosë çmime nën koston e prodhimit me qëllim që të largojë konkurruesit e tjerë nga tregu, dhe nën të tilla kushte të tregut kompania dominuese krijon humbje.

Ne rast se firma dominuese nxjerr jashtë tregut firmat e tjera konkurrese ekzistuese me çmimet e saj të ulta dhe pengon hyrjen e firmave të reja në treg, kjo mund të çojë në rritje të çmimeve dhe fitime më të larta. Evidencat direkt të një strategjie grabitqare përbëhen nga dokumentit e

firmës dominuese, siç mund të jenë për shembull planet e detajuara të biznesit që demonstrojnë përdorimin e çmimeve grabitqare në përjashtimin e rivaleve apo në pengimin e hyrjes në treg. Në rastet e të tilla Evidencash direkt, nuk është tjetër gjë e nevojshme për të treguar strategjinë grabitqare të aplikuar. Sidoqoftë, të tilla Evidenca direkt janë tepër të rralla dhe zakonisht një analizë e elementeve indirekt mund të tregojnë qëllimin e vërtete të sjelljes së çmimeve.

Në rast se sjellja e çmimeve mund të ketë vetëm kuptim komercial dhe nuk ekzistojnë të tjera shpjegime të arsyeshme, atëherë kjo tregon për një strategji për grabitje. Është tepër e rëndësishme të gjendet shkalla, kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e mbajtjes së çmimeve të ulta, pasi mund të tregohet në këtë mënyrë efektet përjashtuese. Është tepër e rëndësishme të theksohet, që përjashtimi i konkurrenteve eficient duhet të ndalohej, pasi përjashtimi i konkurrenteve me pak eficient, të cilët nuk janë në gjendje të kenë një ndikim kufizues tek kompania dominuese, nuk duhet të konsiderohet si një problem konkurrence. Qëllimi i Ligjit të Konkurrencës nuk është mbrojtja e çdo firme të veçantë, por të sigurojë që të gjitha firmat e tjera të jenë në gjendje të futen në treg. Në rast se firma dominuese furnizon produkte me çmime të ulta për klientë të veçantë, dhe këta klientë janë klientët aktuale të konkurrentëve në treg, kjo mund të quhet një strategji grabitqare.

Komisioni Evropian dhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë përdorin standarde të caktuar të kostove, poshtë të cilave ka më shumë arsye për të menduar që po ndodh procesi i “grabitjes.” Gjykata Evropiane ka përcaktuar kriteret për vlerësimin e grabitjes:

- Çmimet nën koston mesatare variabile duhen konsideruar gjithmonë si abuzive.
- Çmimet nën koston mesatare totale por mbi koston mesatare variabile duhen konsideruar si abuzive nëse mund të provohet qëllimi për të eliminuar.

Kompanitë Dominuese zakonisht shesin nën kosto në një minimum sasi produktesh dhe klientësh, të domosdoshme për të eliminuar konkurrentët apo për të penguar hyrjen e tyre, për shkak të humbjeve. Një strategji e ardhshme e mundshme për një firmë dominuese mund të jetë rimbledhja e të gjitha humbjeve të bëra nëpërmjet çmimeve të larta.

4. Procedimi penal.

Çështja penale është ngjarje reale, e cila me përmbajtjen e vet tregon një veprë penale konkrete dhe kryerësin e saj, për të cilin zhvillohet procedura penale.¹⁷ Procedura penale, pra, zhvillohet për ndriçimin dhe zgjidhjen e çështjes penale si objekt themelor i procedurës. Posa paraqitet dyshimi i bazuar se është kryer një veprë penale, paditësi i autorizuar inicon fillimin e procedurën penale në të cilën gjykata duhet të analizojë çështjen penale nga aspekte të ndryshme, duke u përpjekur që të ndriçojë faktet që kanë të bëjnë me veprën penale, si bi fjala: vendin dhe kohën e kryerjes së veprës penale, mjetin me të cilin është kryer vepra dhe mënyrën e kryerjes, pastaj faktet që kanë të bëjnë me kryerësin e veprës penale, përgjegjësinë penale të tij, motivin për kryerjen e veprës, etj. Po të mos ekzistonte vepra penale si objekt themelor i procedurës penale, fare nuk do të kishte nevojë e as mundësi për zbatim të procedurës penale.

E drejta e autorit mbrohet edhe nëpërmjet procesit penal .Dënimi penal për shkelje të të drejtave ekonomike dhe morale të autorit parashikohet nga kodi penal .Kështu neni 149 i Kodit penal, në mbrojtje të të drejtave ekonomike të autorit parashikon:

" Riprodhimi tërësisht ose pjesërisht i veprës letrare , muzikore , artistike ose shkencore që i përket një tjetër , ose përdorimi i tyre pa pëlqim të autorit , kur janë shkelur të drejtat vetjake e pasurore të tij , dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet "

Neni 155 i Kushtetutes parashikon " Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara te pagueseve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj .Në këto raste ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese ".

NEni 40/1 i ligjt nr.9124.

Ndërsa mbajtësit e të drejtës së autorit kanë gjithmonë mundësi qe ti drejtohen gjykates në rast se gjenden para këtyre shkeljeve

Neni 148 i kodit penal i vjen në mbrojtje të drejtës morale të autorit per tu njohur si autori i vepres se tij kur parashikon " Botimi ose perdorimi teresisht ose pjesërisht me emrin e vet të një vepre letrare, muzikore, artistike ose shkencore , që i perket një tjetri , perbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet .

¹⁷ E.Sahiti&I.Zejneli, E drejta e procedures penale e R.Maqedonise, fq.61,Tetove, 2017

Sankione penale për shkelje të drejtes së autorit parashiohet edhe nga ligji për të drejtën e autorit, që është një ligj civil . Kështu neni 50 parashikon sanksionin me gjobe ose me burgim deri në një vit për një liste veprimesh , kur këto bëhen pa autorizimin e autorit dhe rezultojnë në shkelje të të drejtave morale e ekonomike të tij .Parashkimi sanksioneve penale në ligje civile është i pazakonte , prandaj ky nen normalisht nuk zbatohet .

4.Mbrojtja e të drejtes së autorit në rast cënimi

Me të drejtë të autorit nënkuptojmë¹⁸te drejtat e autorëve mbi veprat e tyre. Këtë vepër e kryen ai i cili në emër të tij apo në emër të dikujt tjetër, pa autorizim do të botojë, paraqes, prodhoj, distribuojë, emitojë, apo në mënyrë tjetër të paautorizuar do të preke të drejtën e huaj autoriale.

Kjo vepër kryhet me dashje (direkte apo eventuale) e cila duhet të përmbajë në vetë vetëdijen se në një formë i cënon të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. ¹⁹ Vepra konsiderohet se është kryer në rastet kur kryerësi ka ndermarre veprime të caktuara.

Per shkelje të së drejtës së autorit, nëse nuk arrihet një marreveshje midis palëve, personat e interesuar mund të drejtohen gjykatës që ta zgjidhe konfliktin në një gjykim civil . Për të gjykuar nëse ka shkelje të së drejtës së autorit duhen provuar këta elementë:

- Duhet provuar që vepra është nga ato, të cilat mbrohen nga e drejta e autorit.

Sic u tha më lart, jo të gjitha veprat mbrohen me të drejtë autori. Këtu duhet parë se sa origjinale është vepra, nëse ajo ka aq krijueshmeri, sa që të mundrohet me të drejtë autori. Mbetet në vlerësimin e gjykatës për të percaktuar se në c'nivel krijueshmerie duhet për një vepër që të quhet vepër origjinale.

- Duhet identifikuar e drejta që i është shkelur dhe duhet vertetuar që paditësi është mbajtësi i asaj të drejte . Kur paditësi është vetë autori , atëherë kjo është e thjeshtë, sepse autori prezumohet mbajtësi parë i të gjitha të drejtave ekonomike të autorit . Në qoftëse paditësi nuk është autori , por personi, të cilin i kanë kaluar të drejtat , gjykata duhet të kalojë licencën apo kontratën e tjetërsimit dhe të shikojë nëse behët fjalë për shkeljen pikërisht të asaj të drejte , që

¹⁸ Ismail.Z, E drejta penale, pjesa e posacme, fq.54, Tetove, 2007

¹⁹ Po aty

ka kaluar me license , apo kontratë tjetërsimi (shitje , dhurim) etj. Per tu legjitimuar në ngritjen e padisë, paditësi duhet të jetë pronari i së drejtës që pretendohet se është shkelur, ose mbajtësi i licensës ekskluzive për atë të drejtë. Ndërsa mbajtësi i nje license joeksluzive, mendoj, se mund të vije në gjykatë si person i trete.

- Duhet provuar që përdorimi i të paditurit është i paligjshëm. Përdorimi i paligjshëm përbën kryerja e cdo veprimi, që bën pjesë në të drejtat ekonomike të autorit, pa marrë paraprakisht pëlqimin e tij. Kështu që riprodhimi i veprës ,përkthimi i saj, përgatitja e veprave të prejdardhura, importimi, deklarimi i veprës para publikut, komunikimi i veprës për publikun , të gjitha këto perbejnë shkelje të së drejtës së autorit, nëqoftëse kryhen pa pëlqimin e tij .

Gjithsesi, ka disa përdorime, të cilat, megjithëse kryhen pa pëlqimin paraprak të autorit, nuk përbën shkelje të të drejtave të tij, këto quhen kufme të të drejtave ekonomike të autorit. Kështu, shpesh i padituri mund të mbrohet duke thënë se përdorimi i tij është nga ato përdorime, të cilat janë të lejuara për publikun. Këto lloj përdorimesh janë të mirëpërcaktuara në ligj, ne kreun për kufizimet e të drejtave të autorit dhe, përveç tyre, nuk mund të ketë përdorime të tjera. Prandaj Gjykata duhet të tregojë kujdes që tu qëndrojë strikt atyre dispozitave ligjore dhe të mos i interpretojë ato gjërisht, sepse në fund të fundit, ato janë kufizime të të drejtave të autorit .

5.Kuptimi i mashtrimeve kundër pasurisë

Me vepër penale kundër pasurisë kuptojmë ato vepra penale që shfaqen në marrjen e sendit të huaj në mënyrë të kundershtshme të kryer me dashje dhe me qëllim përfitimi material për vete ose në dobi të personave tjerë ose në dëmtrim apo shkatërimin e saj.²⁰ Sendet janë të luajtshme dhe të paluejtshme.

Vjedhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë

²⁰ I.Zejneli,E drejta penale-pjesa e posacme, fq.112, Tetove, 2007

vjet.²¹ Nisur nga formulimi i bërë në nenin 134/2 të Kodit Penal, duhet pranuar se ekzistenca qoftë dhe vetëm e rrethanës “pasoje e rëndë”, në rastin e vjedhjes së pasurisë, është e mjaftueshme që vepra penale e kryer nga personi të cilësohet sipas këtij paragrafi. Interpretimi i termit “pasoja të rënda” duhet parë në raport me vetë figurën e veprës penale, me raportet shoqërore që ajo mbron dhe duhet analizuar në çdo rast me disa rrethana që lidhen me dëmin e shkaktuar nga vjedhja. Duke u nisur nga fakti që figura e veprës penale të vjedhjes ka pasojë pakësimin e pasurisë së tjetrit në mënyrë të kundërligjshme, Kolegjet e Bashkuara evidentojnë faktin se një ndër kriteret bazë për të përcaktuar pasojën e rëndë është vlera e pasurisë së vjedhur, e cila do të merret në çdo rast e lidhur me rrethanat e tjera që kanë ndikuar te subjekti i dëmtuar.

²¹ N.134, i Kp.Shqiperise

KAPITULLI I III

1. Parimet baze te funksionimit te Autoritetit te Konkurrences dhe zhvillimet kryesore (misioni ,vizioni dhe objektivat),

Parimet e konkurrencës në Shqipëri, mbrohen me ligjin organik nr. 9121, date 28.07.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrencës”. Qëllimi kryesor i ligjit: mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, institucioneve përgjegjese per mbrojtjen e konkurrences dhe pergjegjesite e tyre.

Parimet e konkurrences ne Shqiperi, mbrohen me ligjin organik nr. 9121, date 28.07.2003 “Per Mbrojtjen e Konkurrences”. Qellimi kryesor i ligjit: mbrojtja e konkurrences se lire dhe efektive ne treg, duke percaktuar rregullat e sjelljes se ndermarrjeve, institucioneve pergjegjese per mbrojtjen e konkurrences dhe pergjegjesite e tyre.

Autoriteti i Konkurrences mund te filloje procedurat e hetimit me nismen e tij, me kerkese te Kuvendit dhe me kerkese te institucioneve rregullatore te sektoreve perkates ne te gjitha rastet, kur veren se ka shkelje te dispozitave te ligjit “Per mbrojtjen e Konkurrences“.

Autoriteti nuk ka kompetenca te evidentoje krijimin e monopoleve shteterore, por eshte i autorizuar te nderhyje vetem per qellim te rivendosjes se konkurrences kur ajo shkelet, deformohet apo pengohet.

Konkurrenca efektive sjell përfitime për konsumatorin si për shembull

- çmime të ulta,
- produkte me cilësi të lartë,
- zgjedhje e gjerë e mallrave dhe shërbimeve.

Nëpërmjet kontrollit të bashkimeve, Autoritetet e Konkurrencës mund të ndalojnë përqendrimin që mund të kishte të ngjare t’u hiqte këto përfitime konsumatoreve *nëpërmjet rritjes së fuqisë së tregut të firmave*. Fuqi në rritje e tregut do të thotë aftësi e një apo disa firmave të rrisin çmimet, të zvogëlojnë prodhimin, zgjedhjen e mallrave dhe shërbimeve cilësore, pakësimin e inovacioneve, ose të ndikojnë parametrat e konkurrencës. Përqëndrimi i fuqisë ekonomike kryhet

nëpërmjet bashkimeve, marrjes së pushtetit, sipërmarrjeve të përbashkëta dhe të tjera arritje të ushtrimit të kontrollit.

Neni 13 i LK ndalon bashkimet, të cilat rrezikojnë të krijojnë ose forcojnë një pozitë dominuese. Kjo do të thotë që duhet të ketë një lidhje shkakësore ndërmjet bashkimit dhe pozitës dominuese që mund të krijohet. Kjo lidhje sigurisht që mungon në rastin kur bashkimi i ndërmarrjeve ndodh me qëllim eliminimin e falimentimit të një ndërmarrjeje të caktuar. Në këtë rast lejohet dhe autorizohet përqendrimi bashkimi.

Ky rast përfshin, kur:

- Ndërmarrja e blerë ndodhet në një situatë të tillë, që pa këtë përqendrim, duhet të dalë nga tregu në një të ardhme të afërt,
- Nuk ka një mundësi më pak antikonkurruese se realizimi i këtij përqendrimi, dhe;
- Nuk ka mundësi për riorganizimin e veprimtarisë së kësaj ndërmarrjeje (ç'ka presupozon se prodhimi do të ulet).

Fusha e konkurrencës është një fushë kyçe për realizimin e zonës së tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian. Për të vendosur një konkurrencë të lirë dhe të ndershme në tregun shqiptar, Shteti shqiptar është i angazhuar të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenet 27, 38 dhe 39 të Marrëveshjes së Ndërmjetme dhe në nenet 40, 70, 71 dhe 72 të MSA - së. Për të arritur këtë objektiv, dukuritë që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë si marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet e marra dhe praktika të cilat kanë si objektiv ose pasojë parandalimin dhe kufizimin e konkurrencës, apo abuzimi me pozitën dominuese nga një ose shumë ndërmarrje në territorin shqiptar, do të eliminohen.

Mekanizmi i cmimeve duke vepruar nëpërmjet ofertës dhe kerkesë, në tregje të konkurrencës zgjidh problemet ekonomike të tregut pa intervenim shtetëror apo shoqëror pa dispozita e direktiva.²² Mirepo kjo nuk do të thote se karakteri tregtar i ekonomisë, dmth mekanizmi i tregut, mekanizmi i cmimeve siguron kurdoherë rezultate ekonomikisht optimale.

Konkurrenca mund të jetë lojale nëpërmjet cmimeve dhe cilësisë më të mirë, shumëllojshmërisë më të madhe dhe luksoze, kushteve të shitjes ose edhe jolojale me informime

²² Sinan Ademaj, Bazat e ekonomisë, fq.190, Prishtine, 1998

joreale për mallin dhe për kushtet e shitjes së konkurrentëve, me pagimin e konkurrentit për të prodhuar, duke e paguar në blerjen e lëndës së punës etj.²³

Konkurrenca e pakufizuar, e plote apo konkurrenca e përsosur paraqet sipas Samuelsonit-atë gjendje ku asnjë prodhues apo pronar i faktorëve të prodhimit nuk është në gjendje që të ndikojë vecmas në cmimet e tregut.²⁴ Në rastin e kundërt kemi një shkallë më të madhe apo më të vogël të jopërshtatshmërisë së konkurrencës ose mospërsosshmërisë monopolistike.

2. Marrëdhënia e politikës së konkurrencës me politikat e tjera,

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit, Shqipëria ka hyrë në një fazë të re të partneritetit me Bashkimin Evropian. Kjo fazë kërkon zbatimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, detyrime të cilat nuk janë gjë tjetër veçse zberthimi i tre kritereve të Kopenhagenit: kriterin politik, ekonomik dhe atë të legjislacionit. Kriteri ekonomik kërkon që Shqipëria të zhvillojë një ekonomi tregu, të aftë për ti ballë konkurrencës së tregut të brendshëm të Bashkimit European. Në funksion të krijimit të një ekonomie të tillë, konkurrenca mund të konsiderohet si elementi themelor.

Çështjet e konkurrencës mbeten tejet të rëndësishme për tregun e përbashkët evropian dhe vendet anëtare. Realizimi i tregut të brendshëm bazohet tek konkurrenca midis prodhuesve të mallrave dhe shërbimeve. Politika e konkurrencës është konsideruar gjithmonë e domosdoshme në nivelin komunitar me qëllim që të favorizojë efektshmërinë ekonomike dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, të cilët mund të përfitojnë në këtë mënyrë të mira dhe shërbime në kushte më të mira. Kjo politikë është përcaktuar që në fillim në Traktatin e Romës dhe mund të konsiderohet si një nga politikat më të rëndësishme të Komunitetit. Politika evropiane e konkurrencës zhvillohet në pesë drejtime:²⁵

²³ Po aty

²⁴ Po aty,

Por, gjendja e konkurrencës së plote merret si model i domosdoshëm i analizave ekonomike. Nëse cmimet e ndonjë malli të ofruar janë me ulatë do të paraqiten me shumë me shumë konsumatore që do të dëshironin të blejnë këtë mall. Pra, kërkesa efektive për mallrat që ofrohen me cmime me të ulëta do të jete me të madhe. Prandaj, kërkesa efektive vetëm në bashkëveprim me ofertën cakton strukturën dhe vëllimin e prodhimit të mallrave të vecanta, dmth, çfare do të prodhohet, cili lloj malli dhe me çfare sasi do të prodhohet.

²⁵ Policy - Making in the European Union Fifth Edition. Helen Wallace , William Wallace and Mark A.Pollack.

- Ajo ka për objektiv të *eliminohet monopolizimin e disa tregjeve* duke ndaluar që ndërmarrjet, me anë të marrëveshjeve proteksioniste, të ndajnë tregun mes tyre. Neni 81 i Traktatit i ndalon marrëveshjet dhe praktikatat e rregulluara bashkërisht midis ndërmarrjeve, të cilat mund të prekin tregtinë midis shteteve anëtare dhe që kanë si objektiv ose që sjellin pengimin, kufizimin apo prishjen e lojës së konkurrencës brenda tregut të përbashkët. Në marrëveshjet e ndaluara bëjnë pjesë gjithashtu marrëveshjet që caktojnë direkt ose indirekt çmimet, marrëveshjet mbi kushtet e shitjes, përcaktimin e kuotave të prodhimit, marrëveshjet që ndajnë tregjet apo burimet e financimit etj. Gjithsesi disa tipe bashkëpunimesh të konsideruar pozitive, mund të autorizohen nga Komisioni në momentin që ato lejojnë përmirësimin e prodhimit dhe të shpërndarjes, ose kur ato promovojnë progresin teknik ose ekonomik (për shembull marrëveshjet e ekskluzivitetit, marrëveshjet që lejojnë transferimin e teknologjisë, marrëveshjet e specializimit apo ato të zhvillimit dhe marrëveshjet kërkimore). Komisioni ka të drejta të shumta për të hetuar mbi ndërmarrjet e dyshimta për praktika monopoliste. Në fund të një procedure që i jep ndërmarrjes mundësinë për tu mbrojtur Komisioni mund të kërkojë që ti jepet fund praktikës në fjalë. Ai gjithashtu mund të imponojë gjoka në shumën 10% të xhiros vjetore. Ndërmarrja mund të bëjë një ankim pranë Gjykatës së Drejtësisë, por përgjithësisht Komisioni dhe Gjykata ndjekin të njëjtat orientime.
- Politika evropiane e konkurrencës synon të *mënjanojë abuzimin e pozicionit dominues*. Një pozicion dominues është një situatë supremacie ekonomike që i lejon një ose shumë ndërmarrjeve të pengojnë mbajtjen e një konkurrence të vërtetë në treg dhe ka abuzim të pozicionit dominues kur qëndrimi i kësaj ndërmarrjeje mund të influencojë mbi strukturën ose shkallën e konkurrencës në treg. Në rastet e abuzimit të pozicionit dominues Komisioni ndërhy.
- Për të *mënjeluar krijimin e pozicioneve dominuese*, përqendrimet e ndërmarrjeve kontrollohen kur bëhet fjalë për ndërmarrje mbi një masë të caktuar dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre në shumë shtete anëtare. Këto përqendrime duhet të deklarohen në Komision, i cili mund ti ndalojë kur ato krijojnë ose përforcojnë një pozicion dominues nga i cili rrjedhin pengesa të rëndësishme për një konkurrencë të vërtetë. Ndalime të tilla bëhen rrallë, por ato përbëjnë një kërcënim të dobishëm. Bashkimet e ndërmarrjeve janë

shumëfishuar që prej viteve '80 dhe sidomos '90, janë bërë shpesh të nevojshme për të përballuar konkurrencën ndërkombëtare.²⁶

- Politika e konkurrencës ka gjithashtu si objektiv të *ndalojë ndihmat publike që tjetërsojnë konkurrencën* duke favorizuar disa ndërmarrje apo disa prodhime. Megjithatë Traktati parashikon përjashtime të ndryshme, veçanërisht për ndihmat e caktuara për promovimin e zhvillimit ekonomik të disa aktiviteteve apo disa rajoneve. Për çdo ndihmë apo regjim ndihmesh duhet të njoftohet Komisioni dhe ai duhet ta aprovojë atë para se ajo të jetë hedhur për ekzekutim. Edhe sot Komisioni dhe Këshilli kanë si detyrë të zvogëlojnë nivelin e përgjithshëm të ndihmave publike dhe të mos lejojnë që këto ndihma të tjetërsojnë konkurrencën, duke privilegjuar objektivat horizontalë si përkrahja ekonomike dhe sociale.

Rregullat e konkurrencës zhvillohen si në ndërmarrjet publike ashtu edhe në ato të cilave shtetet anëtare u japin të drejta të veçanta dhe ekskluzive. Sipas Nenit 86 të Traktatit ndërmarrjet e ngarkuara për administrimin e një shërbimi me interes ekonomik të përgjithshëm apo që paraqesin karakterin e një karakterin e një monopoli fiskal, u nënshtrohen rregullave të konkurrencës deri në masën që zbatimi i këtyre rregullave nuk lejon përmbushjen, sipas të drejtës apo praktikës, të misionit të veçantë që u është ngarkuar bashkërisht.

Komisioni dhe gjykatat evropiane e zbatojnë ligjin dhe politikën e konkurrencës gjithmonë duke pasur parasysh funksionimin e një tregu të vetëm. Procesi i anëtarësimit të dymbëdhjetë shteteve të reja si dhe negociatat me shtetet e tjera kandidatë dhe kandidatë potenciale, kanë treguar se edhe për politikën e konkurrencës, çështja thelbësore është Integrimi Evropian.

Për të lehtësuar procesin e integritit evropian, Bashkimi Evropian e konsideron të nevojshme dhe të domosdoshme që, duke filluar nga dita e parë e hyrjes në bashkësinë evropiane, të gjitha shtetet kandidatë të njohin e të zbatojnë kuadrin ligjor në fuqi. Ekonomitë e shteteve anëtare duhet të fillojnë të funksionojnë brenda një kuadri të pranueshëm rregullator, që ndalon zhvillimin e tregjeve kundër interesave të vetë vendeve të asociuara dhe krijimin e strukturave të monopolizuara dhe jo-eficente. Në këtë mënyrë, një politikë aktive konkurrence do të ndihmonte në procesin e tranzicionit, duke krijuar struktura të shëndetshme ekonomike dhe duke shmangur përfitimet antiligjore dhe jo normale.

²⁶ Fjalorth për Integrimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian. MInistria e Integritit.

Është e rëndësishme që procesi i përafrimit, i përcaktuar në marrëveshjet evropiane, të vazhdohet në të gjitha fushat e politikës së konkurrencës. Marrëveshjet nuk kërkojnë detyrimisht përshtatjen e plotë të “*acquis communautaire*” në fushat respektive dhe me të gjitha hollësitë, por është e detyrueshme që të harmonizohen parimet bazë, brenda një kuadri të përshtatshëm strukturor. Duhet të theksojmë se procesi i integritimit nuk është i kufizuar vetëm në përshtatjen e ligjeve dhe të rregulloreve ose në ndërtimin e strukturës.

Përpjekje të vazhdueshme duhet të bëhen për të siguruar zbatimin e politikës, për ta bërë atë të njohur publikisht dhe për ta pranuar nga të gjithë aktorët ekonomikë të përfshirë në proces pra, për qeveritë, ndërmarrjet dhe shoqatat e tyre si dhe sigurisht për konsumatorin. Tregu më i gjerë pranohet nga të gjithë lojtarët, vetëm nëse përcaktohen rregulla loje të barabarta dhe kërkohet zbatimi efektiv i tyre. Dështimi në këtë aspekt, do të sillte konflikte të cilat sigurisht që do të çonin në rishfaqjen dhe rivendosjen e kufijve dhe masave mbrojtëse të shteteve anëtare karshi njëra tjetrës.

2.1. Bashkëpunimi me institucionet homologe të konkurrencës

Me hapjen e ekonomisë dhe liberalizimin e tregtisë dhe tregjeve, Shqipëria po bëhet gjithnjë e më shumë pjesë e zhvillimeve globalizuese duke e integruar ekonominë e saj në rajon dhe drejt tregut të përbashkët evropian. Nënshkrimi i marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit dhe me Bashkimin Evropian, hapja ndaj investimeve të huaja, privatizimet e ndërmarrjeve të sektorit strategjik dhe procesi i liberalizimit të licencave, kanë shtruar “rrugën” për ardhjen e ndërmarrjeve ndërkombëtare nga vende të ndryshme të BE-së ose jashtë saj. Ky bashkëpunim bëhet i domosdoshëm edhe sepse çështjet e konkurrencës marrin karakter mbikombëtar. AK bashkëpunon me autoritetet homologe si në shkëmbimin e informacionit, proceset e hetimit dhe vendimmarrjes.

AK është anëtar me të drejta të plota që prej vitit 2003 i Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN), ku aderojnë dhe 65 Autoritete të Konkurrencës nga shumë vende të botës. Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës bashkëpunon ngushtë me organizatat ndërkombëtare të tilla si: OECD-ja, OBT-ja, UNCTAD-i. Ndonëse nuk ushtron funksionin si organizëm vendimmarrës, rrjeti kërkon t’u mundësojë autoriteteve të konkurrencës mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe diskutimin mbi çështjet praktike të konkurrencës. Nga kjo synohet arritja dhe përmirësimi i

bashkëpunimit mbarëbotëror të Autoriteteve të Konkurrencës dhe arritja e politikave të përbashkëta të konkurrencës, përmes një dialogu të vazhdueshëm.

Për të rritur zbatueshmërinë e ligjit, Autoriteti i Konkurrencës po bashkëpunon me entet rregullatorë. Përcaktimi dhe njohja e ndërsjellët e këtyre përgjegjësive shmanë mbivendosjen e akteve juridike të dala nga këto institucione dhe mënjanojnë ndërhyrjet në kompetencat ligjore të njëri – tjetrit. Mënyrat e veçanta të bashkëpunimit janë përcaktuar në memorandumet e bashkëpunimit midis AK dhe enteve rregullatorë. AK kur konstaton kufizime dhe shtrembërime të konkurrencës në treg, si rrjedhojë e një barriere administrative, por nuk mundet të ndërhyjë me vendim të drejtpërdrejtë, që do të prekte autonominë e institucioneve, mund t'i drejtojë entit rregullator ose institucionit të ngjashëm dhe me funksion të barabartë me të, rekomandime për masat që duhet të marrë, që instrumentet e përdorura të jenë në përputhje me objektivin e përcaktuar.

3. Konkurrenca si një faktor i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në BE, kultura e konkurrencës bashkëpunimi me Bashkimin Europian dhe (TAIEX).

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka gëzuar një stabilitet makroekonomik dhe një rritje të qëndrueshme ekonomike, prej 6%. Sipas Raportit të Konkurrueshmërisë Globale, 2006-2007, Shqipëria radhitet në vendin e 98-të për Indeksin e Konkurrueshmërisë midis 125 shteteve. Konkurrenca në Shqipëri ka njohur dy etapa të zhvillimit:

- *Vitet 1991-2003.* Në këtë periudhë filloi të krijohet ekonomia e tregut, dhe bashkë me të filluan të shfaqen edhe rreziqet nga praktikant anti-konkurruese. Më 7 dhjetor 1995 u miratua Ligji Nr. 8044 “Për Konkurrencën”, me të cilin mbyllet faza e institucionalizimit të politikës së konkurrencës në vendin tonë. Miratimi i ligjit “Për Konkurrencën“, me asistencën e GTZ-se, mundësoi ngritjen e strukturës së parë për Konkurrencën, atë të Drejtorisë së Konkurrencës Ekonomike pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit, e cila u karakterizua nga një paqëndrueshmëri institucionale, si dhe Komisioni i Konkurrencës, i cili përbëhej nga pesë anëtarë, të emëruar nga Ministri që mbulonte Tregtinë. Ligji trajtonte çështjet që lidhen me monopolet,

pozicionin dominues, si dhe ato të konkurrencës së pandershme. Gjatë kësaj periudhe Ligji Nr. 8044 “Për Konkurrencën” ka pësuar vetëm një amendim në vitin 1998, me ligjin nr. 8403, datë 10.09.1998 “Për një shtesë në ligjin nr 8044, datë, 07.12.1995 “Për konkurrencën”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 23, datë 10.10.1998, faqe 897. Sidoqoftë, gjatë zbatimit të tij u ndeshën një sërë problemesh që nuk kishin gjetur zgjidhje në legjislacion. Megjithatë, periudha 1996-2001 karakterizohet nga një paqëndrueshmëri e strukturës të Konkurrencës dhe për rrjedhojë e stafit të trajnuar.

- *Viti 2003 - në vazhdim.* Në këtë periudhë, u bë e qartë nevoja për ndryshime ligjore dhe institucionale në fushën e konkurrencës. Me gjithë zhvillimet e politikës së konkurrencës gjatë kësaj periudhe, u konstatua se legjislacioni përkatës kishte mangësi dhe ishte larg legjislacionit, institucioneve dhe Politikave të Konkurrencës të BE-së. U bë evidente se legjislacioni kishte nevojë jo thjesht për amendimin e ligjit ekzistues, por për hartimin e një ligji të ri, për mbrojtjen dhe nxitjen e konkurrencës, në të cilin rregullat anti-konkurrese do të kishin rolin kyç, dhe ku zbatimi i tij do të realizohej nga një autoritet i pavarur.

Kështu, më datë 28.07.2003 u miratua ligji aktual Nr. 9121 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, një ligj bashkëkohor që mundësoi ngritjen dhe funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës. Ai është i zbatueshëm në të gjithë sektorët e ekonomisë, si dhe për të gjitha ndërmarrjet, private dhe shtetërore, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për ndërmarrjet që veprimtarinë e ushtrojnë jashtë këtij territori, por pasojat e saj ndihen në tregun e brendshëm. Funkzioni kryesor i Autoriteti të Konkurrencës si institucion i pavarur publik është zbatimi efektiv i ligjit të konkurrencës dhe krahas me avokatinë të influencojë sidomos qeverinë dhe sektorin privat për të zbatuar politika pro-konkurrence.

4. Kuadri ligjor dhe Politika Kombëtare e Konkurrencës

Rritja e lirisë së veprimit duke hequr pengesat për tregtinë, mund të çojë në çrregullime të ndjeshme, prandaj është e nevojshme të vendosen dhe zbatohen një numër rregullash transparente për konkurrencën. Në mungesë të këtyre rregullave, si dhe për shkak të sjelljeve anti konkurrese të firmave në treg, do të dështonte përdorimi efikas i burimeve të disponueshme.

Legjislacioni i konkurrencës duhet të përcaktojë rregullat e sjelljes jo vetëm të ndërmarrjeve por edhe të shtetit. E drejta e konkurrencës është pikërisht disiplina, e cila ka për qëllim që të vendosë rregulla për aktivitetin ekonomik, prandaj mund ta quajmë ndryshe edhe “*Kushtetuta Ekonomike*”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton sistemin ekonomik të Shqipërisë, si një sistem që bazohet në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Konkurrenca në Shqipëri rregullohet nga Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Si pasojë e përfshirjes së Shqipërisë në reformën legjislative dhe institucionale në fushën e konkurrencës dhe në procesin e Stabilizim ~Asociimit. Ligji, në tërësi, ka një përjasje në shkallë të lartë me legjislacionin evropian në këtë fushë duke qartësuar në mënyrë të konsiderueshme veprimin e Autoritetit të Konkurrencës, si një institucion publik i pavarur në mbrojtje të konkurrencës në treg. Ky ligj ka zëvendësuar Ligjin Nr. 8044 i datës 7 Korrik 1995 “Për Konkurrencën”.

Ligji i vjetër rregullonte të drejtat dhe detyrimet e të gjithë pjesëmarrësve në treg. Pjesëmarrësit në treg janë të gjithë konsumatorët dhe klientët që kërkojnë mallra apo shërbime si dhe firmat e ndryshme që i ofrojnë ato. Ligji përcaktonte rregullat e veprimtarisë ekonomike të këtyre pjesëmarrësve, me qëllim që ata të vepronin në një situatë konkurrence të drejtë, si dhe parashikonte të drejta për konsumatorët dhe firmat konkurruese që ata të mbroheshin nga konkurrenca e pandershme.

Aktualisht, mbrojtja e konsumatorit rregullohet tashmë nga ligji i ri për mbrojtjen e konsumatorëve. Ligji i ri “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” ka për qëllim të mbrojë konkurrencën në vetvete, si një e mirë publike. Në këtë mënyrë mbrojtja e konkurrencës efektive i shërben interesit publik.

Ligji për konkurrencën krijon mundësinë e mbikëqyrjes së tregut në dy mënyra:²⁷

- duke kontrolluar veprimet e ndërmarrjeve nëpërmjet mbikëqyrjes së marrëveshjeve të ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve të cilat kufizojnë konkurrencën dhe duke mbikëqyrur abuzimet e mundshme të ndërmarrjeve që zotërojnë pozitë dominuese në treg dhe;

²⁷ Këllezi, Pranvera. *E Drejta e Konkurrencës*

Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (I ndryshuar)

- duke kontrolluar strukturën e tregut e cila arrihet me anë të kontrollit të përqendrimeve të ndërmarrjeve duke penguar kështu krijimin e një strukture tregu që krijon mundësinë që në të ardhmen të mund të abuzohet me të. Konkurrenca rrit mirëqenien e shoqërisë, pasi vetë shoqëria përfiton nga çmimet e ulta, produktet me cilësi të mirë dhe nga zgjedhja më e madhe që i ofrohet konsumatorëve.

LK zbatohet mbi ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve që ndikojnë ose mund të ndikojnë në treg. Në mbështetje të ligjit organik funksional të Autoritetit të Konkurrencës, Komisioni i Konkurrencës ka miratuar një sërë rregulloresh dhe udhëzimesh të cilat ndihmojnë në vlerësimin dhe analizën e rasteve që paraqiten për zgjidhje para institucionit. Kuadri ligjor sekondar në fuqi, përveç ligjit bazë në fushën e konkurrencës është:

- Vendimi nr. 58, datë 15.10.2007, “Për miratimin e Rregullores “Për Funkcionimin e Autoritetit të Konkurrencës”;
- Vendimi nr. 7, datë 01.06.2004, “Për miratimin e Rregullores “Për Zbatimin e Procedurave të Përqendrimit të Ndërmarrjeve”;
- Vendimi nr. 8, datë 01.06.2004, “Për miratimin e Udhëzimit “Për formën e Njoftimit të përqendrimeve dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar”;
- Udhëzimi “Për Përfshirjen nga Marrëveshjet”;
- Vendimi nr. 10, datë 29.06.2004, “Për miratimin e Rregullores “Për Caktimin e Shpenzimeve për Ndjekjen e Procedurave pranë AK”;
- Vendimi nr. 9, datë 01.06.2004, “Për miratimin e Rregullores “Për Gjobat dhe Lehtësimin prej tyre”;
- Vendimi nr. 69, datë 24.12.2007, “Për miratimin e Kodit të Etikës së Autoritetit të Konkurrencës”;
- Vendimi nr. 76, datë 07.06.2008, “Për miratimin e Udhëzimit “Për Përcaktimin e Tregut Përkates”;
- Vendimi nr. 68, date 24.12.2007, “Për miratimin e Udhëzimit “Për Vlerësimin e Pasojave të Legjislacionit mbi Konkurrencën”;
- Vendimi nr. 80, date 05.06.2008, “Për miratimin e Rregullores “Për zbatimin e Procedurave të Përqendrimit të ndërmarrjeve”;
- Vendim nr. 14, date 26.01.2005, “Për miratimin e Udhëzuesit “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve”.

KAPITULLI I IV

2. Të dhëna mbi vendimet e Komisionit të konkurrencës


Në bazë të nenit 82 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës, të akteve normative në fuqi. Autoriteti i Konkurrencës do të përqendrohet në mënyrë të veçantë në vlerësimin e shkallës së kufizimit të akteve normative të cilat parashikojnë kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin; që vendosin të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara, që parashikojnë të njëjtat praktika mbi çmimet ose kushtet e shitjes .Për të vlerësuar shkallën e kufizimit ose pengimit të konkurrencës nga aktet normative në fuqi, nevojitet një analizë e plotë të akteve normative dhe e kushteve të tregut. Vetëm një analizë e plotë bën të mundur vlerësimin e pasojave të akteve normative mbi konkurrencën.

Në radhë të parë, analiza duhet të vlerësojë shkallën e konkurrencës në treg, dhe të bëjë pyetjen a ka konkurrencë të mjaftueshme në treg. Për këtë, numri i konkurrentëve që operojnë në një treg përkatës përbën një element të rëndësishëm.

Në radhë të dytë, analiza duhet të vlerësojë pengesat në hyrje, në veçanti pengesat e vëna nga aktet normative, ose siç quhen ndryshe pengesat ligjore. Disa shembuj të pengesave ligjore janë licencat dhe vendosja e kushteve të tjera për fillimin e një aktiviteti ekonomik. Analiza e këtyre pengesave duhet të nxjerrë në pah rolin që luajnë ato dhe sidomos domosdoshmërinë e tyre.


Masat e marra nga aktet normative duhet të parashikojnë vetëm kushte të domosdoshme që kanë lidhje me hyrjen në treg dhe në përpjesëtim të drejtë me arsyet që justifikojnë këto pengesa. Çdo masë e marrë, e cila është në shpërpjesëtim me qëllimin që duhet të arrihet, pengon dhe kufizon në mënyrë të pajustificueshme konkurrencën. Vlerësimi i pengesave ligjore në hyrje bën të mundur dhe vlerësimin e konkurrencës potenciale, ose konkurrencës që mund të vijë si rezultat i presionit që ushtron rreziku i hyrjeve të reja në treg.

Në vijim po paraqes organigramën e Autoritetit të Konkurrencës.




Në bazë të neneve 69 dhe 70 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës duhet të vlerësojë shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës që rrjedh nga çdo projekt-akt normativ, në veçanti të projekt-akteve që parashikojnë kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin, që vendosin të drejta ekskluzive ose të drejtave të veçanta në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara; që parashikojnë të njëjtat praktika mbi çmimet ose kushtet e shitjes, ose që mund të rrisin barrierat në hyrje, përfshi këtu rregullimin ekonomik dhe administrativ.

Në vijim jepet një paraqitje grafike e vendimeve të marra nga AK për periudhën 2004-2008.



Vihet re se përqindja më e lartë e vendimeve është marrë në sektorin e kontrollit të përqendrimeve, kryesisht në sektorin bankar, sipas grafikut të mëposhtëm. Numri më i madh i vendimeve është marrë në vitin 2007, vit i cili përkon me forcimin e kapaciteteve të AK.



28

²⁸ Tabela Përmbledhëse e vendimeve të marra nga AK e shprehur në shifra.

3. Hetimi në Prokurimet publike

Një tjetër kërkesë e lirisë së qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve është dhe hapja e prokurimeve publike. Për këtë arsye palët dëshirojnë të japin aksesin në prokurimet publike mbi një bazë jo diskriminuuese, transparente, konkurrence të lirë dhe reciprociteti (neni 74). Shoqëritë e shtetit të asociuar të vendosura ose jo në KE, dhe shoqëritë komunitare të vendosura në Shqipëri do të kenë akses në procedurat e prokurimeve publike respektivisht në Komunitet dhe në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin komunitar në këtë fushë, menjëherë me hyrjen në fuqi të marrëveshjes. Parimi i mos-diskriminimit midis shtetasve të shtetit të asociuar dhe atyre komunitarë duhet të respektohet plotësisht. Sikurse kemi përmendur për realizimin e qarkullimit të lirë të mallrave, marrëveshja ndalon futjen e mekanizmave të reja pengesë për shkëmbimet, si dhe përkeqësimin e masave ekzistuese. Por mbrojtja e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare mund të justifikojë marrjen e masave të tilla. Në këtë rast kufizimi justifikohet nga e drejta ekskluzive që rrjedh nga pronësia intelektuale. Për këtë arsye shteti i asociuar angazhohet të garantojë një mbrojtje të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare me të njëjtat standarde si ato komunitare.

Prokurimet publike për herë të parë u parapane KPM-se ne vitin 2004 duke u zgjeruar edhe në n.353 të KPM me veprën penale veprat penale kundra detyres zyrtare me ç'rast politikë penale u ashpërsuan seriozisht nëse kryhen keqpërdorime në prokurimet publike. Rregullimi për keqpërdorimet me procedurat e prokurimit publik nuk dha fryt, dhe në vitin 2009, u fut një inkriminim i veçantë nga neni. 275-c në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë, Shpërdorim i procedurës për shpalljen publike, dhënia e kontratës së prokurimit publik ose partneriteti publiko-privat.²⁹

Ai i cili me vetëdije do të shkelë rregullat për procedurë për thirrje publike, dhënie të kontratës për furnizim publik apo partneritet publik-privat me parashtrimin e dokumentacionit të pavertetë, me lidhje të marrëveshjes me pjesëmarrjes të tjere të mundshëm për të bishtuar procedurën për

-
- Paraqitje Grafike e situatës së konkurrencës në treg

²⁹ Zakonot za izmenuvanje i dopolnuvanje na Krivičniot zakonik, „Služben vesnik na Republika Makedonija“ br. 114/09 od 14.9.2009 godina; N.Tupančeski/D.Kiprijanovska, Novo (separatno) kazneno pravo za javnite nabavki, Pravnik, br. 261, 2014 godina

dhënie të kontratave për furnizim publik, me moskryerje të obligimeve nga kontrata me qëllim që i njejtë të bishtnohet apo në mënyre tjetër me qëllim që të shkelë rregullat e asaj procedure dhe më të për vete apo për tjetërkend do të realizojë dobi më të madhe pasurore, apo do të shkaktojë dëm më të madh, nese nuk janë plotësuar vetitë e vepres tjetër më të rënde, do të denohet me dënim me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.(n.275-c, i KPMV).

Sanksionet në fushën e prokurimit publik, konkretisht dënimi me burgun dhe gjoba për disa parregullsive, duhet të çojnë drejt krijimit të një sistemi të prokurimit publik i cili do të bazohet në një shkallë të lartë të transparencës, konkurrencës, trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi i operatorit ekonomik.”³⁰

3. Hetimi në sektorin e prodhimit të betonit

Në këtë rast. AK ka vendosur të ndalojë një marrëveshje në tregun e prodhimit të betonit në qarkun e Tiranës. Nëpërmjet një artikulli në media e shkruar, AK u vu në dijeni të një marrëveshjeje të lidhur nga ndërmarrjet prodhuese të betonit, nëpërmjet të cilës ato fiksonin çmimet e prodhimit të betonit. Duke u nisur nga sa më lart, AK vendosi hapjen e hetimit në tregun e prodhimit të betonit, dhe kundër shoqërive pjesëmarrëse në këtë marrëveshje. Duke qenë një shkelje flagrante e ligjit, Komisioni i Konkurrencës menjëherë vendosi ndalimin e marrëveshjes midis këtyre ndërmarrjeve.

KK me vendimin nr. 56 datë 24. 09.2007 vendosi ndalimin e Marrëveshjes në Tregun e Prodhimit të Betonit në Qarkun e Tiranës” . Ky vendim u ndërmor pasi u konstatua që Ndërmarrjet nën hetim kanë nënshkruar një marrëveshje e cila:

- Fiksonte çmimet e shitjes së betonit sipas markave:
 - Marka 200 65 Euro/metër kub
 - Marka 250 67 Euro/metër kub
 - Marka 300 72 Euro/metër kub
- Rriste çmimet e betonit me 2 euro për metër kub, për shkak të rritjes së çmimit të çimentos me 6 Euro për ton përfshirë TVSH-në ;

³⁰ Maja Malahova Kazneno-pravna zaštita na javnite nabavki so poseben akcent vrz vonkrivičnite propisi fq.232

- Vendoste kushte të tjera tregtimi, siç janë ndalimi i kreditimit për firmat ndërtuese të cilat janë debitore ndaj firmave anëtare të Unionit të Prodhuesve të Betonit.

Në të vërtetë palët në marrëveshje e kishin pranuar se ato kishin bërë një marrëveshje të tillë, por ato pretendonin se këtë marrëveshje nuk arritën asnjëherë që ta vinin në zbatim. Nga ana tjetër vetë AK e pati mjaft të vështirë për të vërtetuar se marrëveshje në fjalë ishte zbatuar dhe kohën gjatë të cilës ajo ishte zbatuar. Në këto kushte, KK vendosi të ndalojë këtë marrëveshje, duke mos vendosur ndonjë gjobë palëve pjesëmarrëse në të. Megjithatë, duke vijuar procedurat hetimore, në bazë të LK, është e nevojshme mbledhja dhe sigurimi i informacionit të duhur që do të ndihmojë në analizën e rastit. Ndërmarrjet nën hetim janë të detyruara të sjellin gjithë informacionin e kërkuar nga AK.

Ndërmarrjet të cilave i ishte drejtuar kërkesa për informacion e AK-së, nuk i janë përgjigjur kërkesës për informacion sipas shkresës “Njoftim për Vendimin e Komisionit të Konkurrencës për ndërprerjen e marrëveshjes dhe kërkesë për Informacion” bashkangjitur formularin, në bazë të nenit 61 të Kodit të Procedurave Administrative. KK në zbatim të LK vendosi edhe një datë për zhvillimin e seancës dëgjimore duke i dhënë kështu palëve mundësinë për tu shprehur dhe të sillnin pretendimet e tyre në lidhje me shkeljen e evidentuar. Mirëpo asnjë nga përfaqësuesit e shoqërive prodhuese të betonit nuk u paraqit në seancën dëgjimore.

Shkresës së sekretariat për depozitim informacioni pranë ambienteve të AK, ndërmarrjet e prodhimit të betonit nuk iu përgjigjën dhe bazuar në ligj ky veprim përbën shkelje dhe si pasojë KK ka vendosur marrjen e masës së gjobës për shkelje të lehtë ndaj këtyre ndërmarrjeve me 0.1 % të xhiros vjetore të vitit 2006. Dy nga ndërmarrjet prodhuese të betonit janë ankuar në gjykatën e shkallës së parë në lidhje me këtë vendim. Gjykata ka rrëzuar kërkesën ankimore të këtyre palëve në të dyja rastet duke i dhënë kështu të drejtë KK me vendimin e tij.

4.Hetimin e thelluar ne tregun e importit te grurit dhe prodhimit te miellit,

AK me nismën e vet ndërmarr një hetim në sektorin e prodhimit të drithërave në qarkun e Fierit. Arsyeja ishte një artikull në gazetë nëpërmjet të cilit njoftohej se prodhuesit e bukës në qarkun e Fierit, kishin lidhur një marrëveshje të cilën e publikuan dhe nëpërmjet të cilës ata zotoheshin që asnjë prej tyre të mos e shiste bukën më poshtë se sa një çmim i caktuar, i vendosur prej tyre. Çmimi i fiksuar ishte shitja masive e bukës në 100 lekë, dhe rritja e të gjitha produkteve të tjera të bukës me rreth 17%. Si pasojë, bazuar në Ligj Sekretariati i AK filloi procedurat hetimore në lidhje me këtë rast.

Komisioni i Konkurrencës me vendim menjëherë ndaloi marrëveshjen e lidhur. Megjithatë, nga hetimi rezultoi se marrëveshja e lidhur midis prodhuesve të bukës nuk ishte vënë në zbatim dhe se secili nga prodhuesit e bukës aplikonte çmimin e tij bazuar në koston e prodhimit të bukës. KK i dha mundësi ndërmarrjeve që nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, të merrnin pjesë në seancën dëgjimore që do të zhvillohej dhe të shprehnin pretendimet e tyre në lidhje me këtë shkelje.

Përfaqësuesit e ndërmarrjeve prodhuese të bukës u paraqitën në seancën dëgjimore të organizuar nga KK dhe shprehën keqardhjen e tyre në lidhje me marrëveshjen, sollën fakte dhe prova të cilat vërtetonin se marrëveshja nuk ishte bërë efektive. Gjithashtu, u evidentua se këto ndërmarrje ishin të mesme dhe të vogla (kryesisht biznese familjare).

Përfaqësuesi i shoqatës së prodhimit të bukës, i cili ishte dhe nismëtari dhe organizatori i marrëveshjes së lidhur, konfirmoi qëndrimin e tij dhe pranoi se ai kishte qenë nismëtari në rastin konkret. Si rezultat KK me Vendimin nr. 67, datë 24.12.2007 vërejti se ndërmarrjet prodhuese të bukës, anëtare të shoqatës së prodhuesve të bukës “Apollonia” Fier, kanë bërë një marrëveshje që bie në kundërshtim me dispozitat e LK, sepse fikson dhe rrit çmimet e shitjes së llojeve të ndryshme të bukës.

Gjatë procedurave hetimore, gjatë seancës dëgjimore dhe deklaratave të vetë Kryetarit të shoqatës së prodhuesve të bukës, është konstatuar se ai ka qenë nxitësi dhe organizatori kryesor i kësaj marrëveshje. Ai vetë ishte shfaqur në median e shkruar dhe vizive duke deklaruar lidhjen e kësaj marrëveshje e cila bie në kundërshtim me LK. Në këtë mënyrë Komisioni i Konkurrencës, bazuar të LK, vendosi marrjen e një sanksioni individual ndaj Kryetarit të Shoqatës së Prodhuesve të Bukës.

Si në rast e prodhuesve të betonit ashtu edhe na rastin e prodhuesve të bukës, evidentohet fakti se bizneset nuk janë shumë të njohura me dispozitat e ligjit mbi kartelet. Në këtë këndvështrim, është detyrë e AK-së që të bëjë një punë të madhe në drejtim të publikimit të dispozitave të ligjit dhe drejt krijimit të kulturës dhe ndërgjegjësimit të publikut për konkurrencën në tërësi.

5. Rast për kontrollin e përqendrimeve / Hetimi ne Sektorin Bankar

³¹Ligji i ka dhënë kompetencën AK të shqyrtojë rastet e kontrollit të përqendrimeve të ndërmarrjeve, të cilat mund të sjellin krijimin ose forcimin e një pozicioni dominues në treg. Në këtë mënyrë KK kur vëren se konkurrenca në treg nuk pengohet, kufizohet ose shtrembërohet si pasojë e një bashkimi përqendrimi ai e autorizon këtë transaksion. Në rast të kundërt ai e ndalon transaksionin financiar të blerjes së aksioneve. Megjithatë mund të ketë edhe raste kur autorizimi lejohet, me kusht që AK të monitorojë sjelljen në treg të ndërmarrjes e cila përfton kontrollin. Në rastin e mëposhtëm, përqendrimi nuk sillte pengim potencial të konkurrencës në treg dhe si pasojë KK e ka autorizuar atë.

Me vendimin nr. 51, Datë 09.05. 2007 Komisioni i Konkurrencës ka autorizuar përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 80% të aksioneve të Bankës Amerikane të Shqipërisë tek Intesa San Paolo. Në bazë të njoftimit të realizuar nga pala blerëse, për përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes të 80% të aksioneve nga BAA tek Intesa Sanpaolo S.p.a. Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të njoftimit të përqendrimit, ka konstatuar se:

³¹ Korah, Valentine. *Cases and materials on EC Competition Law*,

- Intesa Sanpaolo me seli në Torino dhe Milano, Itali, njoftuesi/blerësi i pjesës prej 80% të aksioneve të Bankës Amerikane të Shqipërisë (BAA), është shoqëri anonime, që ushtron veprimtari bankare dhe sigurimesh në tregun ndërkombëtar dhe kombëtar.
- Në tregun kombëtar, kjo shoqëri ushtron veprimtari bankare sipas licencës së lëshuar nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet Bankës Italo-Shqiptare (BIA), ku zotëron 76.12% të kapitalit aksionar të barabartë me 118 aksione. Tregu kombëtar gjeografik i Bankës Italo Shqiptare Sh.A, përbëhet nga degët në 4 qytete Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë. Indirekt Intesa San Paolo është e pranishme në tregun kombëtar, nëpërmjet Credit Agricole që zotëron 71.97% të aksioneve në Emporiki Bank dhe në degët e saj në Tiranë, Vlorë dhe Sarandë.
- Transaksioni i njoftuar konsiston në shitblerjen e 80% të aksioneve të pjesës së kapitalit në BAA nga Intesa Sanpaolo S.p.a të barabarta me 12 milionë aksione të BAA-së. Në përfundim të këtij transaksioni, Intesa Sanpaolo S.p.a do të zotërojë 80% të aksioneve të BAA-së .
- Ky transaksion është një përqendrim që përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me LK.

Në këtë raste Tregu përkatës i produktit është: Pranimi i depozitave bankare Dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare,; Marrje hua të mjeteve financiare dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve; Kryerja e shërbimeve të pagesës; Emetimi dhe administrimi i mjeteve të pagesës, duke përfshirë pagesat me kartë, me çeqet e udhëtarit dhe çeqet e bankierit; Ndërmjetësinë për transaksione monetare, përfshirë valutat; Lisingu financiar si dhe Kryerja e shërbimeve si agjent financiar ose këshilltar financiar

Ndërsa Tregu Gjeografik: Territori i Shqipërisë. Rrjeti aktual i Bankës Italo Shqiptare Sh.A, (Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë); BAA (Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Lushnjë) dhe Emporiki Bank (Tiranë, Vlorë, Sarandë).

Për sa i përket vlerësimit të impaktit në konkurrencë transaksioni konsiston në përftimin e drejtpërdrejtë të pronësisë së pjesës të BAA-së në tregun bankar, nëpërmjet procedurës së shitblerjes së aksioneve. Nga analiza post-përqendrimit, vërehet se tregu është i hapur për konkurrencë, pa barriera hyrëse dhe karakterizohet nga prania e konkurrentëve të fortë, me pjesë tregu të konsiderueshme dhe konkretisht në tregun e depozitave, bonove të thesarit, kredive etj. Përqendrimi sjell ndryshime në strukturën e tregut bankar, duke e forcuar dhe rritur pozicionin e

Intesa Sanpaolo jo vetën në tregun e kombëtar, por edhe në atë ndërkombëtar. Pavarësisht nga sa sipër, ky përqendrim i parë në këndvështrimin e efektivitetit të tregut, rrit konkurrueshmërinë në tregun bankar, zgjerimin e tregut të produktit dhe tregut gjeografik duke nxitur futjen e shërbimeve/produkteve të reja dhe numrin e degëve dhe agjencive në nivel kombëtar, rritjen e standardeve të bankingut për shkak të eksperiencës që ka Intesa San Paolo në tregun ndërkombëtar, etj. Për sa më lart KK vendosi të autorizojë, përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së 80% të aksioneve të Bankës Amerikane të Shqipërisë nga kompania Intesa San Paolo, Itali.

6.Hetimi ne tregun e telefonise se levizeshme

Si pasojë e ankesave të shumta nga Shoqatat e Mbrojtës së Konsumatorëve, artikujve të paraqitur në media, të cilët pretendonin se tregu i telefonisë së lëvizshme në Shqipëri operon me çmime më të larta se ato të vendeve të rajonit, AK me nismën e tij ndërmori një hetim në këtë sektor. Hetimi përfshinte periudhën 2004-2005 dhe zgjati dy vjet. Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2007 ka përfunduar hetimin për abuzimin me pozitën dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme. Palët e përfshira në këtë hetim ishin dy kompanitë që veprojnë në tregun shqiptar, AMC Sh.A dhe Vodafone Sh³²

Më konkretisht, KK shqyrtoi çështjen e abuzimit me pozitën dominuese të shoqërive Albania Mobile Communication sh.a dhe Vodafone Albania sh.a në tregun e telefonisë së lëvizshme, ose shkelje të tjera të konkurrencës në këtë treg për periudhën 2004-2005. Hetimi paraprak i Autoritetit i Konkurrencës filloi në Shtator të vitit 2005 dhe më 11 tetor 2005 Komisioni vendosi nisjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e telefonisë së lëvizshme në përgjithësi dhe veçanërisht në shoqëritë AMC sh.a dhe Vodafone Sh.a, për sa i përket ekzistencës ose jo të abuzimit me pozitën dominuese ose shkelje të tjera të konkurrencës në këtë treg.

Në bazë të vendimit të Komisionit të Konkurrencës, Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të këtij hetimi, Sekretariati ka paraqitur pranë

³² *Vendimi i KK “Për abuzimin me pozitën dominuese të shoqërive AMC sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”- marrë nga Buletini Zyrtar i vendimeve të AK-së*

Komisionit të Konkurrencës “Raportin e Hetimit të Thelluar”. Komisioni i Konkurrencës vërtetoi se të dy kompanitë, AMC dhe Vodafone, zotërojnë një pozitë dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme dhe se kishin abuzuar me pozicionin e tyre dominues në këtë treg, gjatë periudhës objekt hetimi, 2004-2005.

Komisioni i Konkurrencës konstatoi se shoqëritë AMC dhe Vodafone kanë abuzuar me pozitën dominuese, duke vendosur çmime të padrejta në tregun e telefonisë së lëvizshme dhe shkelur në këtë mënyrë nenin 9 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Sipas ligjit një ndër format kryesore të abuzimit me pozitën dominuese është zbatimi i çmimeve të padrejta prej tyre.

Në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, u organizuan seanca dëgjimore ku palët nën hetim kanë dhënë pretendimet e tyre mbi Raportin e Hetimit të Thelluar. Mbi bazën e analizave të kryera mbi pjesët e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike e ndërmarrjeve, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezultoi se kompanitë AMC dhe Vodafone kanë pozitë dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme.

Për të arritur në këtë konkluzion, Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar karakterin e padrejtë të çmimit, në radhë të parë duke krahasuar nivelin e çmimit me vlerën ekonomike të produktit, ose ndryshe me koston e tij. Në vijim, duke mos pasur mundësi për të përcaktuar koston e prodhimit, nivelin e çmimit në treg si dhe normën e fitimit, është krahasuar niveli i çmimit ose niveli i fitimit të produkteve të krahasueshme me çmimin apo normën e fitimit të të njëjtëve produkte në tregje të ndryshme gjeografikë. Për këtë arsye u përdorën tre teste:

- vendosja e çmimeve të larta, pa lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit;
- Sigurimi i përfitimeve tregtare, të cilat nuk do të siguroheshin në një treg të prezumuar konkurrues;
- Krahasimi i tarifave me tregje të tjera gjeografike.

Komisioni i Konkurrencës konstaton se, në mungesë të një modeli të kostos së detajuar të shërbimeve, mund të përdoret alternativa krahasuese (benchmark -u), sipas të cilës të dyja shoqëritë, AMC dhe Vodafone, kanë aplikuar tarifa për shërbimin me kartë për thirrjet brenda rrjetit dhe jashtë rrjetit, më të larta se sa mesatarja e rajonit.

Të dyja shoqëritë, AMC dhe Vodafone, kanë aplikuar tarifë terminimi kombëtar mbi dy herë më të lartë, krahasimisht me tarifën mesatare të terminimit të vendeve të rajonit. Të dyja shoqëritë, AMC dhe Vodafone, kanë aplikuar tarifa për shërbimin me parapagim mesatarisht mbi dy herë më të larta se mesatarja respektive e vendeve të rajonit.

Të dhënat e paraqitura konfirmojnë që shoqëritë objekt hetimi kanë aplikuar tarifa më të larta se vendet e rajonit me nivel të Produktit të Brendshëm Bruto (GDP) dhe të ardhura për frymë të krahasueshme me Shqipërinë (p.sh Maqedonia).

Nga raporti i hetimit është konkluduar se kompanitë AMC Sh.A dhe Vodafone Albania janë dy ndërmarrje të mëdha jo vetëm në tregun e telefonisë celulare por edhe në ekonominë shqiptare në veçanti. Ato janë pjesë e grupeve ndërkombëtare të telekomunikacionit Cosmote dhe Vodafone, të cilat janë të listuara në bursat ndërkombëtare.

- Të ardhurat e dy kompanive janë rritur ndjeshëm nga viti në vit.
- Fitimi i kompanive përgjithësisht ka pasur një rritje në vlerë absolute.
- Fitimet e larta të këtyre kompanive vijnë si rezultat i aplikimit të çmimeve \tarifave të larta dhe të pajustificuara që ato aplikojnë në treg.
- Ato janë kompani që kanë një fuqi të konsiderueshme ekonomike.
- Kanë nivel të ulët të riskut ekonomik (pavarësisht nga borxhet e këqija që ato kanë) dhe ky është tregues i fuqisë së tyre ekonomiko-financiare.
- Ka shumë barriera hyrëse në tregun e telekomunikacioneve. Numri i vetë operatorëve në këtë treg është i kufizuar për shkak të barrierave ligjore, numri i kufizuar i radio frekuencave, kostot e larta të pakthyeshme, pozita e konsoliduar e operatorëve ekzistues në treg etj. Ndërkohë që është dhënë edhe një licencë për shërbimin e telefonisë së lëvizshme shoqërisë “Eagle Mobile” por kjo shoqëri nuk është bërë efektive dhe nuk është aktive në treg, pasi në kohën e hetimit, akoma nuk ishte mbyllur procesi i privatizimit të Albtelkom Sh.A (kjo licencë iu dha shoqërisë që bleu Albtelkom sh.a).
- Ka pasur mungesë të fuqisë kundërvepruese të përdoruesve në treg, dhe si rrjedhojë është rritur aftësia ndikuese e operatorëve në treg.
- Tarifat kanë qenë të ngrira dhe pa fleksibilitet konkurrues.

Nga një analizë e detajuar ekonomike në rastin konkret, bazuar edhe në dispozitat e ligjit u arrit në konkluzionin se, operatorët shqiptarë të telefonisë celulare, kanë tarifa mesatarisht mbi 2 herë më të larta se ato të mesatares së operatorëve të telefonisë celulare të rajonit. Duke pasur parasysh se kostot e këtyre shërbimeve për operatorët celularë të rajonit të marrë në shqyrtim, janë të përafërta me ato të operatorëve celularë shqiptarë, arrihet në përfundimin se AMC dhe Vodafone aplikojnë tarifa ndjeshëm më të larta se kostoja e tyre, c`ka do të thotë çmime të padrejta në këndvështrim të ligjit.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të nenit 9 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), sipas të cilit vendosja e çmimeve të padrejta nga kompanitë, konsiderohet abuzim me pozitën dominuese dhe si e tillë ndalohet kategorikisht nga ky ligj, vendosi:

- Shoqëritë AMC sha dhe Vodafone sha, kanë abuzuar me pozitën dominuese duke vendosur çmime të padrejta në tregun të telefonisë së lëvizshme gjatë periudhës objekt hetimi (2004, 2005).
- Për shkeljen e konstatuar në pikën 1, shoqëria Albania Mobile Communication sh.a. (AMC) gjobitet me 2 % të xhiros vjetore të produktit përkatës të vitit 2005, që e shprehur në vlerë është 211 552 000 lekë.
- Për shkeljen e konstatuar në pikën 1, shoqëria Vodafone Albania sh.a. (Vodafone) gjobitet me 2 % të xhiros vjetore të produktit përkatës të vitit 2005, që e shprehur në vlerë është 242 633 000 lekë.

Komisioni i Konkurrencës mbështetur në vendimin e mësipërm, ka dhënë gjithashtu disa rekomandime për tregun e telefonisë së lëvizshme. Duke qenë se tregu i telefonisë së lëvizshme është treg i rregulluar nga Enti Rregullator i telekomunikacioneve, KK i ka rekomanduar Këshillit të Ministrave dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve liberalizimin e tregut të telekomunikacioneve nëpërmjet hyrjes në treg të operatorit të tretë “Eagle Mobile” brenda afatit ligjor të parashikuar në kriteret e licencës dhe hapjen e procedurave për një licencë të katërt në këtë treg.

Gjithashtu në këtë vendim, i është rekomanduar ERT-së që dispozitat mbi Operatorët me Fuqi në Ndjeshme në treg, të përshtaten me strukturën rregullatorë për komunikimet elektronike të BE-së, si dhe rishikimin e dispozitave ligjore me synim forcimin e gjobave ndaj kundravajtjeve administrative të kryera nga operatorët. KK ka shprehur domosdoshmërinë e hartimit të metodologjisë së Rregullimit të Tarifave të përdoruesve dhe të interksonjeksionit të dy operatorëve celularë të shpallur OFNT, si dhe rritjen e transparencës dhe respektimin e parimit të mos diskriminimit mes operatorëve të tregut të telefonisë për marrëveshjet e interkonjeksionit.

KONKLUZIONE

Politika e konkurrencës në ditët e sotme është një fushë ku ekonomistët dhe juristët punojnë së bashku, dhe gjithashtu gjyqtarët dhe Autoritetet e Konkurrencës duhet të përvetësojnë koncepte të sofistikuara ekonomike dhe teori për të kuptuar situatat. Pas trajtimit teorik dhe praktik të dy koncepteve themelore: konkurrencën dhe integrimin evropian si dhe pas një studimi sintetik dhe analitik të gjithë dokumentacionit dhe informacionit të marrë nga intervistat dhe anketimet e bëra me subjekte të ndryshme private e publike mund të arrijmë në disa konkluzione. Integrimi ekonomik i Shqipërisë në BE është ngushtësisht i lidhur me ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale. Në krijimin dhe zhvillimin e një ekonomie tregu të tillë, konkurrenca është një ndër faktorët më të rëndësishëm.

Kuadri ligjor dhe institucional në vendin tonë, në këtë fushë, është thuajse i kompletuar dhe i përafëruar me legjislacionin evropian, por më tepër duhet bërë në forcimin e pavarësisë së funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit tonë me atë të BE. Nga ana tjetër, edhe pse një çështje që prek të gjithë konsumatorët dhe komunitetin e biznesin, ende ka mangësi në njohjen dhe respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës. Kjo pasi media nuk ka luajtur deri tani një rol të ndjeshëm në promovimin e së drejtës së konkurrencës dhe publikimin në kohë të vendimeve që janë ndërmarrë nga Autoriteti i Konkurrencës. Ka raste kur media, ushqim të saj ka fondet që mer për publicitetin që i bën kompanive, të cilat kanë pozita dominuese në treg, sikurse është rasti i kompanive celulare AMC dhe Vodafone.

Aktualisht, pranë gjykatave nuk ka një seksion i veçantë me një staf të specializuar për të trajtuar çështjet që lidhen me të drejtën e konkurrencës. Gjithashtu ka mangësi në kurrikulat e Fakultetit të Drejtësisë dhe Ekonomisë për trajtimin e së drejtës së konkurrencës, e cila ndikon drejtpërdrejt në shkallën e profesionalizmit të gjyqtarëve, të cilët gjykojnë këto çështje.

Sipas pyetësorit të zhvilluar me 41 subjekte private, i cili kishte në fokus të tij njohuritë mbi konkurrencën dhe integrimin në BE rezulton se vetëm 10 persona nga 41 të intervistuar mendojnë se Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” është i përafëruar me legjislacionin e BE-së, çka përbën 24,4% të përqindjes së vlefshme.

Në bazë të këtyre të dhënave u mendua që të nxirrej një përfundim i përgjithshëm për të gjitha organizatat private, nëpërmjet një intervali % të përpjesës. Formula e përpjesës është zbatuar

vetëm për disa pyetje që japin një panoramë të përgjithshme të temës. Për pyetjen e parë ky interval rezultoi se ishte në vlerat 11, 3% - 37, 5%. Kuptohet që në këtë rast, siguria për përgjigjen e kësaj pyetjeje është 95 %, çka na bën të mos flasim në terma besimi absolut, ndaj kësaj përgjigjeje.

Pyetjes nëse AK po e kryente siç duhet misionin e saj, i janë përgjigjur pozitivisht 58.5% e të intervistuarve, kjo tregon se besimi tek ky institucion është i lartë. Nga ana tjetër, sipas të dhënave të sondazhit, 46,3 % e të intervistuarve mendojnë se pasiviteti i AK-së dhe ndërhyrja politike ndikojnë në moskryerjen e misionit nga AK.-ja dhe vetëm 7.3 % janë të mendimit se ndikon mungesa e informimit publik në moskryerjen e misionit nga institucioni, ndërsa mungesën e ligjit nuk e konsiderojnë si një faktor në peshë për moskryerjen e funksionit të saj nga AK. Nga të dhënat rezulton se të intervistuarit kanë dijeni se ekziston një ligj për mbrojtjen e konkurrencës.

82.9% e të intervistuarve shprehin bindjen se në rast të ballafaqimit me cenimin e së drejtës së konkurrencës do ti drejtohen AK, duke i denoncuar këto raste dhe rreth 74 % e të intervistuarve mendojnë se AK-ja do t'i jap një zgjidhje problemit.

Sa i përket integritimit të Shqipërisë në BE, të intervistuarit rendisin për nga rëndësia këto politika, ku duhet të fokusohet Qeveria: (i) Liberalizimi i vizave – 41.5 % e të intervistuarve, (ii) Tregtia e lirë – 2,45 %, (iii) Reforma në drejtësi – 9,8 %, (iv) Minimizimi i korrupsionit – 34,1 %, dhe (v) Konkurrenca e lirë dhe e ndershme - 12,25%. Pra, sic vihet re, numri më i madh i të intervistuarve është për një prioritet të politikës së qeverisë ndaj liberalizimit të vizave.

Vetëm 68,3% mendojnë se organizata në të cilën punojnë, do të jetë në gjendje të përballojë konkurrencën e lirë dhe të ndershme edhe në rastin e pranimit të Shqipërisë në BE. Nëse do të nxirrnim një përpjesë të opinionit të përgjithshëm, të organizatave private, do të dilte rezultati 54, 1 % - 82, 4% . Kjo tregon se punonjësit kanë besim në ekzistencën e mëtejshme të institucionit të tyre dhe në luajtjen sipas standardeve evropiane.

Pyetjes nëse BE-ja do ta pranojë Shqipërinë pa plotësuar kushtet e caktuara prej saj, i janë përgjigjur pozitivisht 61 % të të intervistuarve, çka do të thotë se ka një besim dhe dëshirë të qytetarëve për tu anëtarësuar në BE. Nga ana tjetër, të pyetur për zhvillimin e një referendumi të mundshëm për pranim të Shqipërisë në BE, 73,2 % e të intervistuarve do të votonin pro anëtarësimit.

Për sa i përket pyetjes nëse kompanitë shqiptare krahasuar me ato të BE, ndihen më pesimistë lidhur me një konkurrencë jo të ndershme në Shqipëri 73,2 % e të intervistuarve i janë përgjigjur pozitivisht, cka tregon mosfunksionimin e rregullave të tre shtyllave të konkurrencës. Të intervistuarit mendojnë se faktorëve të cilët duhet tu japë më shumë rëndësi AK, sipas prioritetit janë: (i) Abuzimit me pozitën dominuese – 34,15%, (ii) Marrëveshjet e ndaluara – 22%, (iii) Kontrolli i përqendrimeve - 4,9%, (iv) Advokacisë dhe ndërgjegjësimit të publikut - 9,5 %, (v) Politikës kombëtare të konkurrencës - 22%. Pra pesha më e madhe e rëndësisë i është dhënë faktorit të “abuzimit me pozitën dominuese”.

Nga pyetësi u arrit në përfundimin se punonjës të organizatave private të ndryshme, por që kishin të njëjtën veprimtari u janë përgjigjur pothuajse njësoj pyetjeve të zhvilluara. Në këtë konkluzion të fundit na kanë ndihmuar të dhënat që nxorëm nga intervistat e katër mësuesve në shkolla private të ndryshme, shtatë inxhinierë ndërtimi dhe gjashtë ekonomistëve.

REKOMANDIME

Në përfundim të këtij punimi e kemi parë të udhës të dalim me disa rekomandime, të cilat mund të ndihmojnë në respektimin e rregullave të drejta të konkurrencës në treg, në përputhje me angazhimet që Qeveria Shqiptare ka marrë në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Rekomandimet i drejtohen institucioneve, të cilat janë përgjegjës për zbatimin e politikës së konkurrencës dhe për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Politikat ekonomike publike në Shqipëri kanë luajtur një rol të konsiderueshëm për stabilitetin makroekonomik të vendit. Në situatën e tanishme, është urgjente të ndiqen politika ekonomike që rrisin konkurrueshmërinë dhe produktivitetin e ndërmarrjeve, me qëllim rritjen ekonomike dhe, si pasojë, rritjen e mirëqenies së shoqërisë. Ky aspekt, duhet të vihet në qendër të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi.

Duke marrë në konsideratë situatën në të cilën ndodhemi, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zbatimit të vendimeve që merr Komisioni i Konkurrencës. Realiteti ka treguar se merren disa vendime, të cilat mbeten në letër dhe nuk gjejnë fushë zbatimi në jetë. Arsye kryesore për moszbatim e tyre janë kryesisht ndikimet nga forcat e ndryshme politike, bizneseve, etj.

Forcimi i pavarësisë së Autoritetit të Konkurrencës, si institucioni qendror, për hartimin dhe monitorimin e politikës së konkurrencës është një tjetër rekomandim. AK duhet të luajë një rol më aktiv në hartimin e politikave ekonomike kombëtare. Firmosja e Memorandumeve të Bashkëpunimit me institucionet rregullatorë të tregut në Shqipëri dhe me ato homologe në Evropë dhe më gjerë do të ndikonte në adoptimin e praktikave më të mira në këtë fushë.

Ajo që vihet re nga përvoja e shkurtër e punës për zbatimin e ligjit të konkurrencës, është nevoja për përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor dytësor për konkurrencën dhe zgjerimin në të ardhmen i fushës së aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës, të rregulluar me ligj, për të mbuluar sa më mirë zhvillimet e tregut dhe shfaqjeve të praktikave antikonkurrese. Përmirësimi i legjislacionit ekzistues duhet fokusuar kryesisht në forcimin e gjobave ndaj kundravajtjeve administrative të kryera nga operatorët e ndryshëm privat apo publik të tregut.

Ndërmarrja e reformave në kuadër të përafrimit të standardeve shqiptare me ato të BE do të ndikonte në përshpejtimin e integritit të Shqipërisë në BE. Pas një analize të situatës aktuale dhe krahasimit me vendet e tjera të rajonit, Qeveria Shqiptare duhet të aplikojë për marrjen e statusit të vendit kandidat. Mbështetja e këtij procesi, në mënyrë të ndjeshme nga qytetarët shqiptarë dhe

inkurajimi nga institucionet ndërkombëtare duhet të shërbejnë si një impuls për përshejtimin e procesit.

Një rol më aktiv Ministria e Integritit dhe Autoriteti i Konkurrencës duhet të luajnë në promovimin e objektivave të tyre. Njohja e procesit të integritit me avantazhet dhe disavantazhet e tij si dhe njohja e politikës së konkurrencës nga qytetarët dhe bizneset konsiderohet si një faktor shumë i rëndësishëm për zbatimin e këtij procesi.

Në situatën aktuale ku ndodhet Shqipëria (procesi i kalimit nga ekonomia e centralizuar në sistemin e ekonomisë së tregut) autoriteti i konkurrencës duhet të ketë të qartë se masat e ndërmarra për zbatimin e ligjit jo vetëm që do të priten me mosbesim, por edhe nuk do të mirëkuptohen (sidomos nga biznesi). Prandaj është detyrë e AK-së që të luajë një rol të gjerë sensibilizues dhe ndërgjegjësimi me të gjithë aktorët e tregut dhe publikun e gjerë. Në këtë rast është më se e nevojshme sqarimi i plotë i kuptimit dhe qëllimit të ligjit dhe politikës së konkurrencës, si dhe i mbrojtjes së saj me ligj.

Rritja e transparencës dhe respektimi i parimit të mos diskriminimit mes operatorëve të tregut konsiderohen si parime shumë të rëndësishëm në zbatimin e loje të rregullt tregu. Për këtë arsye duhet rritur roli i shoqatave tregtare, sindikatave, shoqatave të konsumatorit gjatë procesit të vlerësimit të një akti normativ në stadin e projektit. Këto grupe interesi duhet të përfshihen që në fazat e para të hartimit të projekt-akteve për konkurrencën.

AK duhet të ketë një rol më të rëndësishëm, në kuadrin e dhënies së koncesioneve për përdorimin e burimeve natyrore dhe të infrastrukturave, për të mos përjashtuar njëkohësisht ndërmarrjet e tjera / hyrjet nga shfrytëzimi i burimeve natyrore. Rritja e rolit të Autoritetit të Konkurrencës për ndërgjegjësimin e autoriteteve dhënëse të koncesioneve, për rreziqet që sjellin të drejtat e posaçme dhe ekskluzive për konkurrencën është shumë i rëndësishëm. Rritja e rolit të AK-së dhe ndërgjegjësimi i autoriteteve dhënëse të koncesionit për rreziqet që sjellin të drejtat e posaçme dhe ekskluzive për konkurrencën

Politikat ekonomike publike në Shqipëri kanë luajtur një rol të konsiderueshëm për *stabilitetin makroekonomik* të vendit. Në situatën e tanishme, është urgjente të ndiqen politika ekonomike që rrisin konkurrueshmërinë dhe produktivitetin e ndërmarrjeve, me qëllim rritjen ekonomike dhe, si pasojë, rritjen e mirëqenies së shoqërisë. Ky aspekt, i lënë deri diku pas dore nga autoritetet publike shqiptare, duhet të vihet në qendër të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi.

BIBLIOGRAFIA

I-Libra

- A.Aliu, E drejta e autorit, Prishtine,1998
- A.Jashari, E drejta afariste, Tetove, 2016
- E.Sahiti&I.Zejneli-E drejta e procedures penale e R.Maqedonise, Tetove, 2017
- E.Ismet, E drejta penale-pjesa e posacme, Tirane,2004
- K.Vlado& Zejneli.I, E drejta penale-pjesa e pergjithshme, Tetove,2018
- Z.Ismail, E drejta penale-pjesa e posacme, Tetove,2007
- I.Salihu, E drejta penale-pjesa e pergjuithshme, Prishtine,2016
- B.Baker, Jonathan. Gavil, Andreë. E.Kovace. Eëilliam, *Antitrust Laë in Prospective. Cases, Concepts and problems in Competition policy.*
- Baraj, Edlira. *Politika e Konkurrencës e BE-së dhe Shqipëria.*
- Bellamy and Child, Macnab, Andreë. Ros QC, Vivian. Roth, Peter. *Materials on European Community Laë of Competition*
- Bishop, Simon. Eëalker, Mike. *The Economics of EC Competition Laë,*
- De Burca, G. *EU Laë* P.Craig. Oxford University Press, 1998
- Korah, Valentine. *Cases and materials on EC Competition Laë,*
- Kuko, Valbona. Kumbaro, Odeta. *Përgatitje për integrimin evropian.* ITAP, 2005
- S.Ademaj, Bazat e ekonomise, Prishtine, 1998
- Jenny, Frederic. *Toëards EëTO Competition Rules: Globalization, Competition and Trade Policy-Issues and Challanges,* 1999
- Robert lane *EC Competition Laë (Euroepan Laë Series)* Oxford 2000.
- Stephen Eëatherill (cases and matiarials) *On Euoepan Union Laë 7th Edition* Oxford 2006
- Alina Kaczoroëska *Laë Of The European Union (second edition 2002)* leading cases

II-Burime tjera

- *Buletini Zyrtar i Vendimeve të AK-së*. Nr. 1, 2004 – 2007
- *Buletini Zyrtar i Vendimeve të AK-së*. Nr. 2, 2007
- Commission notice “*On the concept of full functioning joint ventures under council regulation nr. 4064 on the controll of concetration betëeen undertakings*”
- *Competition Laë*, Richard Èhich
- *Competition Policy Neësletter*, nr 3, 2007;
- Cook. C,J, Kerse. C.S, *EC Merger Control*
- *Kapaciteti Integrues i Bashkimit Evropian*, Ministria e Integritimit, 2007
- *Deklarata për shtyp e AK-së marrë nga faqja zyrtare e AK-së*
- Edlin, Kaloë Areeda. *Antitrust Analyses*. Aspen Publishers
- *EU competition policy and the consumer*
- *Europe in 12 Lessons*, Ministria e Integritimit, 2006
- *Europe on Competition Laë, A practitioner’s guide*, Lennart Ritter and David Braën
- *European Community Laë of Competition*,
- *Fjalor i termave të Konkurrencës*, Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës
- *Fletore zyrtare e RSH, Nr. 71, Gusht 2003, fq 3189-3211*
- Giddens, Anthony. *Sociologjia*, Pegi, 2000
- Hovenkomp, Herbert. Federal Natitrust policy. *The Laë of Competition and its practice*.
- “*Advocacy and Competition Policy*”, ICN
- Jones, Alison. Sufrin, Brenda. *EC Competition Laë*
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Këllezi, Pranvera. *E Drejta e Konkurrencës*
- *Komunikimi i KE për përcaktimin e tregut përkatës për qëllime të përdorimit të ligjit të konkurrencës*, OJ 1997, C 97
- *Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës “(I ndryshuar)*
- *Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit European*
- Motta, Massimo. *Competition Policy, Theory and Practice*.
- *Notice of the European Commission on Research&Development Agreements*

- OECD Investement Compact. *Investment reform Index. Competition Policy.*
 - OECD. *Relationship between regulators and Competition Authorities.* 1999
 - *Politika Kombëtare e Konkurrencës*
 - Raporti i BE-së për Shqipërinë, *Raporti i Stabilizim - Asociimit i vitit 2007*
 - *Rethinking EU Integration, Albanian Perceptions and Realities*, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtarë, 2007
 - *Shqipëria dhe Bashkimi Evropian, MSA dhe më pas*, Ministria e Integritimit, 2006
 - *Trajnim mbi çështjet ligjorë të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore.* Projekti CARDS 2003
 - *Traktati Evropian* (kryesisht nenit 81-81)
 - Udhëzimi i AK-së: *”Për Përcaktimin e tregut përkatës”*
 - *Dokumenti i Partneritetit Evropian Shqipëri-BE*
 - *Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 215, datë 16.5.2002*, “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit negociator shqiptar për përgatitjen e negociatave me Komunitetin Evropian dhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit”
 - *Vendimi i KK “Për abuzimin me pozitën dominuese të shoqërive AMC sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”*- marrë nga Buletini Zyrtar i vendimeve të AK-së
 - www.europa.eu.int
 - Intervistë me Znj. Lindita Milo (Lati), Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës
 - Intervistë me Z. Andras Intosai, Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Konkurrencës/KE
53. Antitrust Law Developments (fourth), *Section of Antitrust Law American Bar Association*

APENDIKSE

- Pyetësi dhe rezultatet e tij
- Tabela Përmbledhëse e vendimeve të marra nga AK e shprehur në shifra.
- Relacioni i Projekt-ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”
- Paraqitje Grafike e situatës së konkurrencës në treg
- Intervistë me Znj. Lindita Milo (Lati), Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës
- Intervistë me Z. Albert Gajo, Zëvendësministër